



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 140, qershor 2015

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355692465784, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Luigj Shyti, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

“HITE VERORE 2015” BUQETË ME KËNGË, GJALLËRI DHE EMOCION

Mes shumë këngëtarësh dhe artistësh në Art Center “Blue Sky”, në qytetin e Shkodrës, startoi edicioni i tretë titulluar “Hite verore 2015”.

Spektator dhe të ftuar, dhjetra artistë, gazetar, moderator, komentator, fotograf dhe kameraman të TV “Blue Sky”, në tapetin e kuq pritën ardhjen e këngëtarëve të ftuar në edicionin e tretë “Hite Verore” 2015.

Në këtë organizim me një përkushtim special shumë këngëtarë u intervistuan dhe secili prej tyre priste me padurim radhën për të dalë para mikrofonit dhe objektivit të kamerave të shumta që të shprehnin kënaqësinë e tyre për pjesëmarrjen dhe vlerat e këtij evenimenti, duke i kushtuar një vëmendje të madhe kësaj interviste, të cilën e vlerësuan si arritje e këtij stafi të mrekullueshëm, si dhe të veçantën e kësaj nate magjike që do të kishte edhe ndarja e çmimeve.

Në skenën e Art Center u ngjiten këngëtarë të ardhur nga Shkodra, Lezha, Tirana, Malësia e Madhe, Treva e Dukagjinit, Tuzi, Ulqini etj.



AT’ ÇIPRIAN NIKA NDËR MË TË DITURIT FRANÇESKAN NË FUSHËN TEOLOGJIKE DHE FILOZOFIKE

At Çiprian Nika ka lindur me 19 korrik të vitit 1900, emrin e pagëzimit e kishte Dedë. Qe i biri i Mëhill Nikës nga lagje Haspshtë e fshatit Celaj të Shoshit. Nëna e la jetim në moshë pesë vjeçare dhe akoma pa i mbushë 7. Prifti i Shoshit e solli Dedën e vogël në Kuvendin e Françeskanëve të Shkodrës, ku përfundoi edhe shkollën e mesme ku falë rezultateve shembullore vijoi e përfundoi studimet...



Shoqëria shqiptare ka nevojë të mendojë më shumë për njeriun!

(BASHKEBISEDIM NË EMISIONIN “KUSH ËSHTË...?”
RTSH, ME ZOTIN LAZËR STANI)

Sipas Gëte-s Malësia është një mësues i pa zë që nxjerr mjeshtria të qetë, të urtë dhe të ditur. Po Malësia e Shqipërisë, sipas jush?

Malësia Shqiptare ka një histori shumë të veçantë dhe tragjike në të shumtën e herës, për shkak të rrethanave historike që ka jetuar Shqipëria dhe mendoj se është një nga zërat më origjinalë...

TRADITA MUZIKORE GJAKOVARE

PROMOVHET NË GJAKOVË LIBRI “TRADITA MUZIKORE GJAKOVARE” E STUDIUESIT DHE MUZIKOLOGUT BEHAR ARLLATI

Në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë u bë promovimi i librit me titull “Tradita muzikore në Gjakovë” e autorit Behar Arllati, profesor i artit muzikor dhe muzikolog i njohur, në të cilin dokumentohen shumë të dhëna, duke pasqyruar në mënyrë krejtësisht të re traditën muzikore të qytetit të Gjakovës. Njëherit kjo vepër, është e para e këtij lloji që me elemente të detajuara evidenton për krimin e jetës muzikore të këtij qyteti.

Thesaret dukagjinase e pathëna që i ka munguar një krahine

VOC DEDA, PATRIOT DHE ARTIST I
FJALËS SË SHKRUAR, CILËSOHET TË
JETË INDIVIDUALITET I SPIKATUR NË
HITERLANDIN DUKAGJINAS QË SHTRIHET
NË TRE SHTETE TË EVROPËS JUGLINDORE

Nga Xhani kanë dalë diplomatë e strategë, shkrimtarë e artistë, mjekë e pilotë, sportistë e gardianë të shëndetit njerëzor, klerikë e linguistë, për të mos e bërë më të gjatë listimin e profesioneve të kultivuara me pasion e durim. Jetëshkrimi i katundit me emrin Xhan...

Instrumentet muzikore ilire dhe Pani Hyu i grigjave e kullotave, muzikant, instrumentist e satir i lashtë i gadishullit

- ME RASTIN E FESTIVALIT
FOLKLORIK KOMBËTAR, TË
GJIROKASTRËS 2015 -

Thuhet se muzika zhytet thellë në prehistori bashkë me njeriun dhe kështu ne njohim shpikiet e instrumentet e lashta muzikore. Vërtetohet se instrumentet e para ishin prej guackash, prej kockash e të tjera. Instrumentet e quajtura si kordofone, si lira e harpa...

NIK ÇARKU PRITET SI SIMBOL I KËNGËS SHQIPTARE NË MALSIËN E MADHE

PËR PAK FUSHË E DISA
MALE, NUK PO I THONË
MALSI E MADHE,
POR E MADHE ASHT
BUJARIA, KU E MUER
EMNIN MALISIA

Malet e kësaj krahine mes alpeesh zënë rrënjë buzë liqenit të Shkodrës dhe përfundojnë në Malësinë e Gjakovës, “me kryet deri në qiell” dhe majat e tyre të mbuluara...

“HITE VERORE 2015” BUQETË ME KËNGË, GJALLËRI DHE EMOCION

Mes shumë këngëtarësh dhe artistësh në Art Center “Blue Sky”, në qytetin e Shkodrës, startoi edicioni i tretë titulluar “Hite verore 2015”.

Spektator dhe të ftuar, dhjetra artistë, gazetar, moderator, komentator, fotograf dhe kameraman të TV “Blue Sky”, në tapetin e kuq pritën ardhjen e këngëtarëve të ftuar në edicionin e tretë “Hite Verore” 2015.

Në këtë organizim me një përkushtim special shumë këngëtarë u intervistuan dhe secili prej tyre priste me padurim radhën për të dalë para mikrofonit dhe objektivit të kamerave të shumta që të shprehnin kënaqësinë e tyre për pjesmarrjen dhe vlerat e këtij evenimenti, duke i kushtuar një vëmendje të madhe kësaj interviste, të cilën e vlerësuan si arritje e këtij stafi të mrekullueshëm, si dhe të veçantën e kësaj nate magjike që do të kishte edhe ndarja e çmimeve.

Në skenën e Art Center u ngjiten këngëtarë të ardhur nga Shkodra, Lezha, Tirana, Malësia e Madhe, Treva e Dukagjinit, Tuzi, Ulqini etj.

Një mbrëmje e paharruar, e mbushur me tinguj muzikorë me prezantimin e krijimeve më të reja të këngëtarëve më të dashur të skenave shqiptare.

Qytetarë shkodranë përjetuan magjinë e këngëve të reja të shpalosur bukur nga këngëtarë të shumtë që kishin ardhur me dëshirën dhe pasionin e tyre, për të qenë të pranishëm në këtë eveniment artistik, si një dëshmi e kulturës dhe traditës shqiptare.

Këto krijime të reja janë pasqyra më e qartë e asaj që ky televizion po evidenton vit pas viti. Arti muzikor është e vetmja gjë që popujt merren vesh me njëri-tjetrin, pa nevojën e një përkthyesi apo ndërmjetësi dhe kjo është bërë traditë edhe në sofrat e shqipes që ky televizion organizon çdo vit në trevat shqiptare, falë pasionit, përkushtimit dhe profesionalizmit të presidentit të TV “Blue Sky” z.Gëzim Brahusha, i cili ka vite që ankoron lokomotivën e këngëtarëve dhe artistëve në qytetin e Shkodrës.

Një pasoinant i veçantë, i heshur, por me punë të mëdha. Veprimtaria e tij është e mbushur me aktivitete të spikatura në fushën e artit muzikor, i cili mbetet jo vetëm një ndër pionierët e parë të kameramaneve, por edhe një ndër aktivistët e parë nga më të respektuarit për të gjithë muzikantët dhe këngëtarët e Shqipërisë e Kosovës.

Aktivitetet e tij janë të shumta, por ai synon ato më pikantet që me të vërtetë e bëjnë jetën e tij shumë interesante, duke i parë problemet deri në detaje, por me dimensione të arritura.

Në natën gjigande të “Hite verore” jehuan këngët, si pjesë e kulturës që zë fill në Shkodër, duke përçarur tinguj e nota muzikore që Shkodrës i burojnë nga shpirti dhe që nuk i shterojnë në asnjë stinë të vitit, duke shpalosur vlerat artistike,

duke i dhënë qytetit mundësinë e momenteve të shumpritur, që të jetonte startin e ardhjes së stinës së verës, me dimensione magjike që vetëm “Blue Sky” di t’i përcjellë.

Spektaklin e hapi këngëtarja Adelina Marku, e cila përveçse e emocionuar ndjehej edhe shumë e lumtur. Ajo falenderoi spektatorët, kolegët e saj këngëtarë si dhe stafin e këtij televizioni që bëri të mundur organizimin e kësaj nate të paharruar.

Më pas rrjedha e këtij spektakli vazhdoi me performimin e këngëtares së mrekullueshme shkodrane Alma Velaj, këngëtare e ndëruar, por në radhë të parë është një qytetare shqiptare e cila nuk është e ngarkuar në detyrat që shteti i vë nëpunësve të vet, por është një ambasadore aktive që me zërin e saj të bukur dhe mesazhin që përcjellin këngët e saj mund të quhet pa asnjë dyshim urë lidhëse midis shqiptarëve në Europë dhe atdheut të tyre.

Kështu kjo këngëtare nga viti në vit e rriti repertorin e këngëve të interpretuara prej saj, jo vetëm duke i përzgjedhur, por edhe duke i interpretuar ato tashmë si një këngëtare profesioniste.

Më pas u ngjiten në skenë njëri pas tjetrit edhe këngëtarët, Ben Dema, Bardh Spahja, Ardian Jaku, Skënder Çela, Lirim Gjonbiba, Greta dhe Mikelina Lazri, si dhe shumë të tjerë të suksesshëm.

Me atmosferën e kësaj nate u bashkua edhe zëri i këngëtares Kristina Marku që kishte ardhur nga Lezha.

Nga Tirana kishte ardhur këngëtarja tanimë shumë e dashur për të gjithë për vokalin dhe interpretimin me mjeshtri të këngëve që ajo shumicën e tyre i ka hite, Elisabeta Marku. Atmosfera e këndshme vazhdoi me këngëtarin e Ansambllit Shtetërorë Dionis Delia.

Një moment shumë i këndshëm ishte kur në skenë u ngjit këngëtar i Operas dhe Baletit Aranit Hoxha me këngën e tij më të re, titulluar “Me këngë dasmen ta urojmë”, me tekst të Ramazan Çekës, muzika nga Sadetin Bajraktaraj, i njohur si dj. Cadi njëkohësisht edhe mjeshtër zëri i këtij evenimenti, i cili sapo është diplomuar nga Akademia muzikore “Muza production Academy “ me president z. Edi Balili.

Kantautori simpatik dhe kompozitori i suksesshëm Zaim Mërkulaj, me këngën e tij e ndërroi krejtësisht atmosferën në sallë duke korrur duartrokitjet e spektatorëve nga performanca që ai i dhuroi të pranishmëve me këngën “Më fal”.

Spektakli u ndez kur në skenë u ngjit këngëtarja që përfaqësonte Malësinë e Madhe Skënder Xhafa me këngën “Do pendoresh”, i cili bëri edhe një falenderim për autorin e tekstit Ramazan Çeka dhe kompozitorin e këngës Zaim Mërkulaj.

Nga Bajza përformoi këngëtarja më e re Elvira Fierza, e cila këngën e

parë të saj titulluar “Pendim i vonuar” e interpretoj në “Hite Verore”.

Në këtë atmosferë mbretëroi në skenë këngëtarja Violeta Deda, e cila pas interpretimit të saj të suksesshëm tha: “E ndjej veten shumë krenare që jam malësore, si brenda edhe jashtë atdheut, jo vetëm se kam pasur një respekt të paparë, por edhe se kjo trevë ka dhe ka pasur shumë artistë, ku duhet ta përmendë patjetër artistin e madh, të ndjerin Sali Mani dhe i ndjeri Kol Vuçi si artistë të paharruar”.

Nuk kishte si të mungonte në këtë spektakël edhe përfaqësuesja nga Tuzi, ikona e TV “Blue Sky”

teksteve dhe kompozimeve të suksesshme Fran Kodra, shoqëruar nga Ndue Shytani, krijuan një atmosferë të këndshme me këngën “Dashuria nuk ka mend”.

Më pas këngëtarja e paarritshme me vokalin e saj Gofile Pappleka përformoi me “Jare Gjakovare”, duke i lënë radhën këngëtarit tjetër të kësaj treve Gëzim Zefi me këngën “Syni jem” me tekst nga poeti dhe shkrimtari në emigracion Danjel Njebza, muzika Tani Berisha, orkestruar nga Dritjon Selmani dhe Roland Çukaj.

Skena buçiti dhe ngjyrat e dritave ranë mbi skenë si mesazhe ar-

presidenti i TV “Blue Sky” z.Gëzim Brahusha, i cili ndiqte çdo detaj, me qëllim që mbarëvajtja e këtij koncerti të ishte perfekte.

Disa nga këngëtarët që mundëm t’i shkëpusim për t’u marrë nga një intervistë, u shprehën me vlerësime maksimale, për organizimin e bukur të “Hite Verore”, që sipas këndvështrimit të tyre ishte perfekt, i kurrar në çdo detaj, prandaj dhe e vlersonin maksimalisht.

Eleganca e disa vajzave dhe djemve këngëtarë e harmonizuar me lukun dhe veshjet, u përcollën bukur përmes një tabloje koreografike të arrirë, ku u ndërthurën këndshëm përmes sinkronizimeve në projektor, çka u demonstrua më së miri me plot energji nga këngëtarët pjesmarrës, duke u treguar mjaft entuziast për praninë e tyre.

Të gjithë këngëtarët treguan seriozitet dhe përgatitje profesionale, çka e përcollën në skenë duke korrur duartrokitjet të forta.

“Hite Verore” uli siparin, duke na dëshmuar edhe një herë vlerat e papërsëritshme të krijimeve të reja, vlera që duhen trashëguar si deri tani nga brezat, nga shpirti i organizatorit, që nuk ndalet, nga pasioni dhe dëshira për të sjell vlerat më të mira në fushën e artit muzikor.

“Hite Verore” u mbështet nga kompania “Arstlgroup TL” (pija energjike B-2) dhe kompania “Baits Albania”, të cilët krijuan kushte të favorshme, për të shijuar bukurinë e kësaj nata gala.

Në përfundim të koncertit erdhi edhe momenti i shumëpritur, i shpalljes së çmimeve në “Hite Verore” 2015, edicioni i tretë, ku përmes emocioneve dhe duartrokitjesh “Çmimi i Karrierës” i akorduar nga TV “Blue Sky” i jepet këngëtares Shkodrane shumë simpatike, Alma Velaj, e cila me zërin e saj të ëmbël, po ruan me shumë fanatizem traditën e bukur të këngës shkodrane. Ky çmim u dorëzua nga humoristi i grupit “Gaz e maraz”, si dhe autor i shumë tekste këngësh Qazim Çela.

Pas merrjes së çmimit këngëtarja Alma Velaj tha: “Ishte një kënaqësi që nuk e prisja, duke patur parasysh që të gjithë pjesmarrësit, kolegët e mij janë shumë të mirë. Ishte një emocion shumë i bukur dhe u ndjeva shumë e vlerësuar. Falenderoj TV “Blue Sky” dhe të gjithë kolegët që më kanë mbështetur”.

“Çmimi i Internetit” e meritoi këngëtarja e mirënjohur nga Tuzi, “Ikona” e Tv “Blue Sky” Gjyete Vulaj dhe “Çmimi i votimit në TV” këngëtarja e mirënjohur që përfaqësoi Tiranën Elisabeta Marku.

Të gjithë pjesëmarrësit ishin shumë të kënaqur me të gjitha detajet e këtij spektakli, pasi çdo gjë ishte arritur ashtu siç ishte parashikuar.

Ndërkohë Presidenti i TV “Blue Sky” z. Gëzim Brahusha deklaroi para spektatorëve dhe këngëtarëve pjesmarrës se “Hite Verore” do të vazhdoi edhe në edicionet e tjera.

Ramazan Çeka



këngëtarja shoëmene Gjyete Vulaj, e cila me performancën e saj të magjishme krijoi në sallë një atmosferë të jashtëzakonshme, duke i lënë radhën kolegës së saj nga Tuzi Marije Lajçaj.

Në “Hite Verore” mori pjesë edhe këngëtarja i cili përfaqësoi Ulqin, Gëzim Salaj, i cili që në fëmërinë e tij iu përkushtua këngës popullore, duke u bërë një nga këngëtarët e njohur si në Ulqin, ashtu edhe në Shkodër. Ai ka dhënë një kontribut shumë të madh në përhapjen e propogandimin e këngës qytetare shkodrane e ulqinake duke mos njohur kufij, i pa lodhur dhe plot gjallëri e pasion, duke u bërë kështu edhe një përçues i denjë i vlerave artistike që ka ai brenda mëllostit të tij të pastër shqiptar. Është këngëtar që ka përformuar në skenat shqiptare dhe në ato kosovare dhe më gjërë në të gjitha vendet ku ka përqëndrime shqiptare si në Europë, në SHBA, deri në Australi.

Ishte e pamundur që përfaqësuesit e Trevës së Dukagjinit të mos ishin të suksesshëm në këtë natë, pasi kantautori i njohur i shumë

dhur nga universi.

Kishte shpirt kjo natë aq sa mblodhi rreth vetes qindra spektatorë, të cilët dhuruan breshëri duartrokitjesh, gjatë interpretimit të këngëve të mrekullueshme që këngëtarët përformuan njëri pas tjetrit duke i dhënë larmi kësaj nate magjike.

Jo vetëm këngëtarët e shumtë, por edhe spektatorët e pranishëm përjetuan emocione nga momente të ndryshme që u krijuan gjatë gjithë kohës, si dhe nga pritja që iu bë nga organizatorët.

Kjo natë solli në vëmendje edhe një herë vlerat artistike që ky televizion sjellë para ekranit të tij, si dhe përkushtimi maksimal me përkrahjen e vazhdueshme të stafit të drejtuar nga Mimoza Brahusha, që i jep talentëve të rinj.

Krahas punës së palodhur të koreografit Aldo Nika, drejtuesit artistik Zaim Mërkulaj, skenografit të teatrit “Migjeni” Hysni Halili, moderatorës simpatike Klediola Loca, si dhe regjisorit Qazim Çela, binte në sy interesimi dhe kujdesi që gjatë gjithë kohës ishte i kudogjendur,

VLERA E IMPERATIVIT KATEGORIK TË KANTIT

REFLEKSIONE FILOZOFIKE NGAT'ÇIPRIAN NIKA

Qyshë në revolucionin e Francës botes moderne jo vetëm se iu dha një trajtë e re politike e administrative por post tepër kjen trembë që në themel bani parimet më kryesore të mendes dhe parimet e edukatës e moralitetit.

Tuj i dhanë njeriut autoritetin e plotë, ky e bani vetveten qendrën e çdo veprim-it, rreth të cilit do të sillej gjithçka. Këputi përpjekjet me botët e mbinatyrshe , bani si të mos ishin çka ai e shihte me sy e se prekte me dorë, tuj u mundu këso dore me vetvetin kakinin e gjithshkahes. Edhe besimet e për lidhje të ngushtë që kanë nder veti, edhe moralitetin e ngushtuam këta kryengritës mendimi brenda caqeve të mendjes së njeriut, kështu që njeriu u ba ligjadhanës e njëherë zbatues ligjit. Mes këtyre filozofive mbas krahit që mori njeriu për normë të veprimeve te veta a do të priste kohën, rasat rrethanat që do ti tregonin se të veprojë a do t'i tregoi arsyeja politike se çfarë do të bënte a do të rregullohej mbas leverdisë endjeve që do të mundahej mej përfitue vetes. Kah pa duket si modë nder disa ambiente kulturave të Shqipnisë me shortue në tru të shqiptarëve mentalitetin filo noterive të shekullit të kaluar, kujtoj se s'ka me kenë jashta vendit t'u paraqitë lexuesve tonë të ndershëm në realitet të vetin, pikëpamjen morale detyre për me pa se

në çë themele mbështetën ata parime që përmbajnë faktorin ma të madhin kulturës, të përparim e të çdo zhvillimit të popullit tonë. Me gjithë arsye Kanti nihet, e ashtë përfaqësues i filozofisë moderne edhe ma të përkundërt u mundu në veprat e para të veta me ua gjet rrëfanën se ku ka me i vjerrë të gjitha përpjekjet të priturat e nevojës se njeriut. Prandaj duke njohur Kantin, shumë a pak nihen edhe përfaqësuesit e tjerë të sistemeve të filozofisë moderne.

Do kishte qite tepër larg puna po të dojshim edhe vetëm me përpilu sistemin e te menduarit të Kantit për rreth çeshtjeve kryesore të njeriut, prandaj po ceki terinë morale të tij që me pa se nga ka e ka nxjerrë Kanti detyrën që kena ne mos me ba keq e me ba mirë. Kanti e filon sistemin moral prej faktit të përgjithë të ndërgjegjes, e cila na detyron me ba mirë e mos me ba keq. Kjo fuqi që detyron mund të rrjedhë vetëm prej një simboli me vlerë absolute. Kushti mbas Kantit, vetëm vullnesa ashtë krejt e mirë. Por edhe kjo vetëm atëherë ashtë e mirë kur vepron vetëm për detyrë due me thanë, pse i thonë ligjësia përmbrendeshme, tuj përjashtue çdo steresë si të kobshme si të përherëshme, pse po bani e vepro i vullnesa për ndonjë qellim tjetër, vepra kishte më kenë ligjërisht e mirë, por moralisht. Për

një vullnesë të mirë lypen dy parime një objektiv, ose ligja që i detyron e një subjektiv që është shkaku i shtysës për e ba një vepër. Po desh pra ndokush me ba një vepër mirë normalisht do të bajë thotë Kanti, vetëm pas i shtymë prej ligjes të përmbrendshme. Kjo Ligjë e përmbrendeshme s'është tjetër arsye praktike ose ndërgjegjja Në këtë mënyrë Kanti sikur u mundua me ba autonominë e njeriun në mendim ashtu deshi me ba edhe me veprim: vullnesa ashtë ligja e vetvetit e njëherë shkasi për të cilin vepron. Ashte e vërtetë se trinimi rregulluesi i veprimeve të njeriut ashtë ndërgjegjja, në mënyrë që po vepron njeriu mbas kësaj ndërgjegje , ashtë i përligjur para vetit, para shoqit para Zotit për veprat e veta, prandaj këtu nuk due me rrahë çeshtjen; a do ti dëgjojmë a por jo ndërgjegjes sonë nder veprimet tona pase nuk ka kuruar dyshimi se do t'i dëgjojmë, por due me shtrua nga i vjen ndërgjegjes ai autoritet që për me gjykue për mbi veprimin e njeriut. Ndërgjegjja, marrë psikologjikisht, ashtë një ajo fuqi ndertë cilën jo vetëm kuptojmë se mendojmë si thotë DESCAR-TES por kujtohemi edhe për ekzistencën tonë e për të gjitha veprimet e përmendueshme tonat. Por kur flasin për ndërgjegje e sidomos kur themi për ndonjërin se është njeri me ndërgjegje nuk kuptojmë gjithë aq ndërgjegjen psikologjike por ma fort marrim përsyshë veprat e tija për pikëpamjen e së mirës dhe së keqes me fjalë të tjera nënkuptojmë ndërgjegjen morale e në këtë kuptim e marrim edhe na këtu. Ndërgjegjja është pra ai gjyqtar i brendshëm që na dëshmon se veprat tona janë moralisht të mira e të këqija e se duhet me i ba ose mos me



i ba .Në secilin veprim të ndërgjegjes na ma se parit japim një gjyq spekulativ, me te cilin themi se ajo vepër ashtë e mirë ose e keqe mandej japim një gjyq praktik: kjo e keq e s'do ba, kjo e mirë e do bahet a mund të bahet, e që se këtu na paraqitet imperativ që na ve me detyrë me indejtë larg së keqes e na urdhëron a por na le të lirë me ba ose mos me ba të mirën. Ideja e detyrës nënkupton në subjekt lirinë . Po të mos ishte njeriu i lirë, nuk kishte me mujtë me u kuptua detyra në të; kishte me kenë krejt një punë e pa vështrim me fol për detyrën, tagër në një kafshë e cila ashtë e ngushtime me vepru në një mënyrë. Vetëm aty ka liri ku ka liri dhe zgjedhje ndërmjet a me ba ose mos me ba një vepër...

(Vijon në nr e ardhshëm)
Botuar në Revistën "Hylli i Dritës"
Nr 12 viti 1933, f. 571-579

AT' ÇIPRIAN NIKA NDËR MË TË DITURIT FRANÇESKAN NË FUSHËN TELOGJIKE DHE FILOZOFIKË

At Çiprian Nika ka lindur me 19 korrik të vitit 1900, emrin e pagëzimit e kishte Dedë. Qe i biri i Mëhill Nikës nga lagje Hashtë e fshatit Celaj të Shoshtit. Nëna e la jetim në moshë pesë vjeçare dhe akoma pa i mbushë 7. Prifti i Shoshtit e solli Dedën e vogël në Kuvendin e Françeskanëve të Shkodrës, ku përfundoi edhe shkollën e mesme ku falë rezultateve shembullore vijoi e përfundoi studimet e Larta Teologjike në Austri. Ku më 26 korrik 1924, shugurohet meshtar ndërsa meshën e parë e kremtoi më 25 korrik 1924. Ishte ndër më të diturit françeskan në fushën teologjike dhe filozofike. Emërohet profesor në Gjimnazin e Fretënve. Kishte pasion muzikën. Nën drejtimin e At Martin Gjokës, merr pjesë në orkestrën frymore të françeskanëve, që përbëhej prej rreth 40 vetësh. Ishte ndër flautistët më të mirë. Zotëronte mirë disa gjuhë, spikati në gjermanisht, frengjisht dhe greqishten e vjetër. Ishte bashkëpunëtor i Revistës "Hylli i Dritës", kryesisht për problemet filozofike, gjithashtu është marrë gjerësisht me menaxhimin e shtypit dhe të botimeve françeskane ku, ka shkruar artikuj me vlerë në fushën filozofike. Njihet si Provinçiali ma i ri në moshë, në vitin 1938 drejton Provinçën e Shqipnisë. Çipriani, nga viti 1938- 1943



ishte Ministër Provinçial i françeskanëve shqiptar, ndërsa nga viti 1943 deri në vitin 1946 kreu detyrën e Drejtorit të Kolegjit "Serafik" duke qenë edhe Guardian i Kuvendit të Shën Françeskut për Shkodrën. Çiprian Nika, si shumica e elitës të asaj kohe, përkrahu e luftoi për Nolin e Gurakuqin, qe këtë te fundit e quante

Apostull të Kastriotit. Armiqësia e Nikës me Zogun thellohet akoma më shumë pas shtypjes së Lëvizjes së Dukagjinit të vitit 1926 dhe terrorit të pa skrupullit që ushtruan bandat e Matit, Dibrës e Lumës ndaj krahinës se tij. At Çiprian Niken, akuza e komunisteve e ka quajtur bashkëpunëtor të hapur të fashistëve dhe si një nga krerët kryesor të Kishës Katolike Shqiptare qe tradhtonte atdheun. At Zef Pëllumbi i ka hedhur poshtë këto akuza, si të pavërteta, fallso dhe denigruese. "At Çiprian Nika ishte një person jo vetëm i padëshiruar, por edhe një antifashist i deklaruar dhe për këtë shkak qe internuar nga fashist. Gjithsesi Pëllumbi nuk është në gjendje të na përcaktojë kohën ekzakte se kur u internua dhe kur u lirua. Ëndrra për një Shqipëri Etnike ishte i vetmi iluzion pozitiv që ushqeu deri diku ndaj falangës së Fuqive të Boshtit. Iluzion që u venit dita-ditës. Ai përjetonte me trishtim njëherësh dy drama: shëndërrimin e botës në kasaphanë nga fashistët dhe përhapjen e komunizmit si reaksion ndaj fashizmit. Ndonëse i bindur plotësisht në fitoren e pashmangshme të komunistëve, Çiprian Nika mbeti i palëkundur, i pa dyzuar dhe në mënyrë të hapur në ballë të rezistencës antikomuniste. Pati edhe nga ata miq që e këshilluan të ikte

për t'i shpëtuar ndëshkimit. Si mundet ta braktisë i pari kapiteni anijen e të lë marinaret e shkretë mes valëve të tërbuara të stuhisë. Si mund të ikë një luftëtar i Krish-tit dhe të lë kryqin në duart e të pafeve, që duan ta shcallmojnë me sopat dhe ta shkulin nga zemrat e njerëzve.- Unë do të qëndroj këtu, do të luftoj e do të flijohem për idealin e krishterë, ashtu siç me datën 26.1947 dhjetor ditë e premtë, ora 3 mbas dreke 1947, filloi gjyqi politik ku u akuzuar se gjatë gjithë jetës së tyre pranë Klerit Katolik kanë zhvilluar aktivitet të rrezikshëm anti-popullor ... duke qenë element me pozitë dhe udhëheqës të Klerit Katolik në Shqipni ... me anën e këtyre lidhjeve të kombinuara me Demokrist-janen kanë menduar për një kryengritje të armatosur kundër.

Me datën 28 dhjetor 1947, Trupi Gjykues dha vendimin: Dënim me vdekje, me pushkatim. At Çiprian Nika u pushkatua më 11 mars 1948, në orën 5. 00 të mëngjesit, në Zallin e Kirit, në Shkodër. Profesor Arshi Pipa ka deklaruar: "Është vështirë me pranë se gjithçka mbaron me trupin kur vërejmë qysh njerëzit vdesin për ideale". I tillë ishte Çiprian Nika, një kreshnik qëndrese e sakrifice për fe, besim e liri.

Prelë Milani

Shoqëria shqiptare ka nevojë të mendojë më shumë për njeriun!

(BASHKEBISEDIM NË EMISIONIN “KUSH ËSHTË...?” RTSH, ME ZOTIN LAZËR STANI)

Sipas Gëte-s Malësia është një mësues i pa zë që nxjerr mjeshtro të qetë, të urtë dhe të ditur. Po Malësia e Shqipërisë, sipas jush?

Malësia Shqiptare ka një histori shumë të veçantë dhe tragjike në të shumtën e herës, për shkak të rrethanave historike që ka jetuar Shqipëria dhe mendoj se është një nga zërat më origjinalë, më autentikë, më shqiptare. Ka jetuar për një kohë të gjatë në izolim, e shkëputur nga bota, nga infomacioni, nga qytetërimi, por gjithsesi ka arritur të ruajë vlera autentike që vijnë prej thellësive të historisë. Është ura më e fortë lidhëse midis paraardhësve tanë të lashtë dhe njerëzve tanë moderne. Nuk kam parë askund njerëz që flasin aq bukur dhe ta kenë vrarë aq shumë mendjen për kuptimin e ekzistencës njerëzore, të qënies së tyre.

Gruaja malësore a ka ngjashmëri me klerikët katolikë? Atë qetësi dhe urtësi shoh, sa herë më ka rastisur të njoh malësore?

Gruaja malësore në përgjithësi, sidomos nëna, është një institucion shumë i veçantë, i rëndësishëm dhe autoritar. Është kujdesur për rritjen dhe edukimin e fëmijëve në radhë të parë me vlera njerëzore, me dashuri, mirësi, me ndjenjën e respektit për tjetrin. Në fakt, institucioni i nderit ka filluar tek nëna, të rrisë një fëmijë që të jetë faqebardhë. Në të njëjtën kohë, institucioni i nënës ka qenë i shenjtë. Femra në traditën dhe zakonet tonë ka qenë shumë e mbro-

jtur, në Kanun femra mbrohet në mënyrë maksimale. Në kodin e gjakmarrjes, kur burri ishte i shoqëruar me gruan nuk kishe të drejtë ta vrisje, deri këtu shkonte respekti për femrën.

Çfarë ka fituar, ose çfarë ka humbur me pluralizmin gruaja malësore?

Mendoj se përpjekja për të emancipuar gratë gjatë periudhës komuniste, nuk solli ndonjë ndryshim të madh, përkundrazi shndërrimi i grave në burra për mua është fatkeqësi. Sot e kësaj dite keqkuptohet koncepti i barazisë gjinore. Lëvizjet e viteve ‘50-’60, për mua nuk sollën ndonjë emancipim, pasi është një proces i gjatë, i thellë, është proces kulturor, proces kultivimi. Sigurisht kushtetuta dhe ligjet vendosin një barazi qytetare dhe kjo është barazia për mua, tendencat e tjera siç aplikohen sot e kësaj dite më duken spekulime. Institucioni i familjes është baza e organizimit shoqëror dhe shumë lëvizje politike, si Partitë Demokratike në të gjithë botën, bazë kanë njësinë e familjes. Mendoj që kombi shqiptar është krijuar nga ky element, nga tradita dhe familja. Nuk është krijuar asgjë nga një kushtetute e fortë, apo ushtri e fortë; as nga gjenerale, apo politikanë të fortë. Rilindjen kombëtare tek shqiptarët e kanë krijuar shkrimtarët, të cilët kanë sakrifikuar talentin dhe kulturën e tyre letrare. Janë disa kombe që krijohen nëpërmjet këtyre proceseve kulturore dhe i tillë është kombi shqiptar. Pikërisht, falë kësaj kulture, familja tradicionale është shumë e fortë.

Një nga personazhet që më ka bërë shumë përshtypje në 24 vite në Shqipëri, ka qënë Don Simon Jubani. Kemi arritur ne, ta kuptojmë atë njeri ashtu siç duhet?

Unë e kam njohur, e kam takuar në vitet ‘90, një njeri me kurajo të jashtëzakonshme, me një moral shumë të lartë. Sipas Biblës së shënjtë, një qenie njerëzore nga një qenie jonjerëzore, nuk dallohet as nga elementet e mendimit dhe as të komunikimit. Në Bibël shkruhet qartë që njeriu është një qenie morale, dhe duke qënë e tillë dallon të mirën nga e keqja dhe mban qëndrim ndaj tyre. Don Simon Jubani ishte një model moral, nuk bënte kompromis me të keqen. Vuafti shumë dhe nuk bëri kompromis me diktaturën. Ishte nismëtar i parë që zhvilloi ceremoninë e parë fetare në vitet ‘90 në Shkodër.

Dhe në ritualin mysliman ishte pjestari i parë.

Po, sepse gjithsesi kombi shqiptar nuk është një komb i krijuar mbi baza fetare. Rilindasit shqiptarë, pavarësisht bindjeve fetare u bashkuan për të krijuar Shqipërinë, sepse besimi është raport individual i individit. Institucionet fetare janë një pasuri shpirtërore e një kombi dhe besimi, institucioni i kishës, sistemi i vlerave që institucionet fetare transmetojnë tek qytetarët duhen respektuar. Në përgjithësi, shumë pasoja të krizës shpirtërore që ka kaluar shoqëria shqiptare pas viteve ‘90, një lloji degradim moral i shoqërisë, i vlerave erdhi nga mungesa e edukimit fetar dhe familjar.

Laiciteti a cënohet në Shqipëri? Si e shikon këtë raport midis fesë dhe shtetit?

Shteti shqiptar duhet ta forcojë shumë qëndrimin e tij laik, duhet të jetë gjithmonë i ndarë dhe i pandikueshëm nga religjionet. Gjithsesi sipas ligjeve të kushtetutës, shteti

respekton të gjitha religjionet, të cilat kanë të drejtën të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në raport me qytetarët dhe bashkëpunon me ta për çështje të caktuara. Por, unë, nuk i besoj shumë shtetarëve që shkojnë në kishë, apo xhami vetëm kur zhvillohet ceremoni të caktuara me praninë e kamerave, sepse është një përpjekje për të përdorur politikisht institucionin fetar. Po të ishte në dorën time, do të hartoja një ligj, që ndërkshon përdorimin e fesë për përdorime politike dhe që e dënon si krim ndaj shtetit. Aq më tepër, për specifikën që ka shteti shqiptar duke dëmtuar harmoninë e krijuar. Ndonjëherë është e pakuptueshme dhe nga të huajt harmonia e theksuar fetare e shqiptarëve. Kjo nuk ndodh, sepse shqiptarët e kuptojnë më mirë raportin e fesë me individin, por sepse kjo harmoni i ka rrënjët shumë të thella. Megjithatë, feja është përdorur në politikë këto 20 vitet e fundit dhe ky është hap mbrapa për shoqërinë shqiptare, sepse dëmtohet stabiliteti dhe e ardhmja e shtetit të ndërtuar me shumë mundim.

Sa përqind e grave në Malësinë e Veriut do të marrin pjesë në votime?

Përgjithësisht marrin pjesë në votime, megjithë zhgënjimin që kanë nga politika. Shkodra këtë herë, të dy kandidatet i ka femra dhe besoj se ky është një zhvillim shumë pozitiv për të sjellë një klimë më qytetare, më njerëzore. Shoqëria shqiptare ka nevojë të jetë më humane, të mendojë më shumë për njeriun. Kjo shoqëri ka nevojë të dalë nga agresiviteti, është një energji e harxhuar në një luftë absurde që nuk prodhon asgjë.

Ahmet Dursun

Abdyl Sadiku (Ndrecaj) “Qytetar Nderi i komunës Kastrat”

Të jetosh, pavarësisht fatit tënd, si jetëgjatë, apo jetëshkurtër, nuk është asgjë e re, sepse edhe njëra, edhe tjetra, pra si jetëgjatësia, apo largimi nga jeta në moshë të re janë brenda natyrës njerëzore, kurse të justifikosh vetveten brenda kufinjve që të fali jeta, kjo është domethënia më kuptimplote e misionit të njeriut si qenia - kryevlerë e kësaj bote.Më 23.05.2015 ,në njërin nga lokalet e preferuara të Malësisë së Madhe,“Dushkaj” , në një prani brilante për nga përfshirja e brezave, e lidhjeve farefisnore, e ngjyrave partiake/jetës politike dhe e shoqërisë civile, malësorët nderuan ,me një dinjitet për ta patur zili , njërin nga bijtë e tyre, veteran: Veteran të jetës, veteran të punës, veteran të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, birin e Malësisë së Madhe, banorin e Komunës Gruemirë, që sot drejtohet nga “e majta”, z.Abdyl Ndrecaj. Vlerat, si përjashtuese ndaj paragjytimeve , ndarjeve krahinore, politike,apo fetare, janë gjithmonë përbashkuese , prandaj, jo rastësisht , në jubileun e lindjes së këtij malësori , nderimi i jubileut të jetës së tij nga familja, të afërmit, shokët, miqtë dhe veteranët , bashkohet edhe urimin e Këshillit të Komunës Kastrat , që aktualisht drejtohet nga “e djathta”. Risitë nuk shfaqen rastësisht, ato manifestohen si prirje progresive, drejt një sjelljeje gjithnjë e më civile, që tenton ndjeshëm , të rritë shtatin në këtë trevë që aq me dinjitet mban vlerësimin presidencial“Nderi i Kombit”. Dhe në këtë ditë nderimi dhe respekti për djalin e tyre , Abdyl Sadikun(Ndrecaj) malësorët manifestuan njërin nga standartet më bashkëkohorë të jetës civile: Nderimin e kontributit të njeriut që gjatë 85 viteve të jetës së tij ar-

riti të mbetet shembëlltyra e thjeshtësisë, e ndjenjës së përgjegjësisë së zhvilluar në veprimtarinë e tij si dhe në respektimin e drejtësisë, barazisë dhe solidaritetit njerëzor, larg ceneve ideologjike, si vlera civile të çdo kohe. Kush është Abdyl Sadiku?

Abdyl i lindi më 23 maj 1930, në fshatin Reç të Malësisë së Madhe, në një familje me tradita të shkëlqyera familjare, të respektit ndaj punës dhe vlerave të saj, të nderimit ndaj vetes dhe të vendit të tij, solidare me njeriun në nevojë dhe liridashëse. I ndodhur përballë faktit të atdheut të pushtuar nga fashizmi , në tetor 1942, pra fillimvitin e 13-të të jetës , vihet në shërbim të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Dhe nuk mund të ishte ndryshe, sepse familja e tij, shtëpia ku lindi ishte njëra nga bazat kryesore të asaj epopeje të lavdishme, që shqiptarët , nën udhëheqjen e PKSH-ës, ditën ta mbështesin, ta udhëheqin dhe ta kurorëzojnë, me dinjitet , në krah të aleatëve të mëdhenj , perëndimorë, SHBA-ës dhe Britanisë së Madhe. Ndonëse në një moshë fare të njomë, korrieri i batalionit partizan“Perlat Rexhepi” do të shquhej për kontributin kundër pushtuesit fashist, pa marrë parasysh asnjë sakrificë. I ushqyer nga dashuria për lirinë dhe vendosmëria për ta merituar atë me çdo kusht, korrieri partizan Abdyl Ndrecaj do ta shtrinte veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e trevës, sidomos në fshatrat Vrakë, Vorfë, Rrjoll, Reç, Grizhë, Gruemirë etj.në mbështetje të rezistencës antifashiste.Kjo nuk ndodhte, aspak, rastësisht, por vinte nga fakti që Abdyl i ishte djali i një familjeje të lidhur ngushtë me këtë lëvizje, Madje, njëra nga bazat kryesore të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, krahas

15 shtëpive apo familjeve të njohura si të tilla, asokohe, në fshatin e tij,Reçin.

Vrasja e bashkëfshatares dhe bashkëmoshatares së tij, Gjylije Bejtos, në tetor 1942, në prag të shtëpisë së saj, ndezi shpirtin e Abdylit të ri , sikurse tek mbarë populli i Reçit dhe i Malësisë së Madhe, zjarin e urrejtjes ndaj pushtuesit dhe shpirtin e sakrificës në emër të shpëtimit të vendit nga okupatori fashist. Gjithë këtë përvojë nderi dhe krenarie legjetime, në ditët tona, Avdyli do ta përcjellë përmes botimit të tri librave : “Luftëtarët e lavdishëm të lirisë”,“Malësia e Madhe dhe bashorët e saj në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare” dhe “E vërteta mbi Luftën e Kelmendit”, tituj ku pasqyrohet, veçanarisht, kontributi i banorëve të Komunës Gruemirë, po, po aq, edhe i banorëve të Malësisë së Madhe gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare kundër pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre.Pas Çlirimit të vendit, dekada në vazhdim, Abdyl Sadiku është ndër veprimtarët shoqërorë dhe drejtuesit e palodhur kudo ku i besohet për ndërtimin ekonomik dhe socialkulturor të fshatit të vet dhe mbarë Malësisë së Madhe. Kryen kursin e Lartë 2- vjeçar pranë Institutit të Lartë të Bujqësisë si dhe vite më pas shkollën e lartë të Partisë në Tiranë.Puna dhe kontributi i tij ka merituar vlerësimin me disa urdhëra dhe medalje, por, mbi të gjitha, ai ka arritur të fitojë pasaportën e respektit dhe të nderimit, si figurë publike në të gjitha pozicionet e drejtimit dhe zhvillimit të përgjegjësive si drejtues ekonomie në Kastrat, apo si drejtues pushteti lokal në Gruemirë etj.Edukimi dhe shembulli i familjes “Ndrecaj” në tërë trevën tonë meriton repektin mbarë, sikurse ka obliguar moralisht dhe institucionalisht konsideratat verbale dhe juridike për punën dhe kontributin e tij.Fjalët më të mira u përcollën, më 23.05.2015, në evenimentin e nderimit të jubileut të tij filluar nga kryetari i

komisionit të vlerësimit të figurave ,në këshillin e komunës Kastrat, z.Gaspër Deda që i dorëzoi edhe titullin“Qytetar Nderi”, dhënë nga këshilli i komunës në fjalë, z.Ndrecaj, vijuar me përshëndetjet dhe mesazhin e nderimit që iu dorezua, në emër të Kryesisë së Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Shqipërisë, nga Zëvendëskryetari i këtij komiteti, z.Faik Aliaj. Përshëndetje dhe përgëzime për kontributin e veteranit Abdyl Sadiku, në fjalën e tyre, shprehen edhe ish- bashkëpunëtorë të tij, përfaqësues të shoqërisë civile nga Malësia e Madhe, këtej dhe andej kufirit shtetëror, intelektualë, studiues, publicistë, si: Ndue Bacaj, Gjokë Luli, Dimtrov Popoviç, Besnik Gjonaj, Anton Luljguraj, Kadri Ujkaj, Sekretari i Përgjithshëm i Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Shqipërisë, z.Odise Porodini, kryeveterani malësor Veli Dushaj , kryeveterani lezhjan Deli Bishja, njëherish anëtar i Kryesisë së Komitetit Kombëtar të Veteranëve të Shqipërisë, kryetari i shoqatës “Malësia” Ilmi Kurti si dhe politikanët malësorë, qeveritarët lokalë: kryetari i Bashkisë Koplik, z.Ramadan Lika, nënprefekti i Malësisë së Madhe, znj.Taze Lohja. Një fjalënderim dinjitoz,krejt i veçantë dhe mbresëlënë, u mbajt në emër të familjes së z.Abdyl Sadiku (Ndrecaj) nga djali i tij, ish-nënprefekti i Malësisë së Madhe, kryetari i shoqatës patriotike “Malësia e Madhe “Nderi i Kombit”, z. Sytki Ndrecaj në nderim të babait të tij dhe po aq të pjesëmarrësve të këtij evenimenti publik: sa familjar, sa shoqëror. Një ditë nderimi që malësorët dhe përfaqësuesit e tyre në pushtetin lokal ia kushtuan vetvetes, jubileut të jetës së djalit të tyre, z. Abdyl Sadiku (Ndrecaj), ndryshe një jete, plot dinjitet, në rrugëtimin e saj prej disa dekadash.

Kadri Ujkaj

Thesaret dukagjinase e pathëna që i ka munguar një krahine

VOC DEDA, PATRIOT DHE ARTIST I FJALËS SË SHKRUAR, CILËSOHET TË JETË INDIVIDUALITET I SPIKATUR NË HITERLANDIN DUKAGJINAS QË SHTRIHET NË TRE SHTETE TË EVROPËS JUGLINDORE

(vijon)

Nga Xhani kanë dalë diplomatë e strategë, shkrimtarë e artistë, mjekë e pilotë, sportistë e gardianë të shëndetit njerëzor, klerikë e linguistë, për të mos e bërë më të gjatë listimin e profesioneve të kultivuara me pasion e durim.

Jetëshkrimi i katundit me emrin Khan, plotësohet me përshkrimin e florës e faunës, elementët e turizmit historik e ekologjik, infrastrukturën si duhet të jetë në të nesërmen që nuk duron të jetë e largët. Pa u zgjatur në risitë që përçon libri që i kushtohet nervaturës së një fisi që është plis e shkëmb, na shkon nëpërmend ta urojmë Voc Dedën, e t'i themi pa asfarë mëdyshje, ke shkruar mirë e bukur! Pastër e me shkëlqim meteorësh!

Një analizë të vëmendshme meriton edhe njëri nga librat e sagës së gjatë “Thesare dukagjinase”. Titullohet “Historiku i Vëllazërisë”. Këtu autori Voc Deda ndalet si çdo udhëtar me përvojë kur i duhet për me ngjithë një të përpjetë të lodhshme. Merr frymë thellë. Yryshin e mënjanon. Sjell nëpërmend breza njerëzorë dhe etapa kohore ndër të cilët ata u përshkuan. Autori numëron gjurmët. Ato janë aq të ngjashme ndërvedi. Kanë një mision të përbashkët. Të mbajnë në këmbë, lisin e gjakut me çdo çmim e sakrificë. Përpos gjurmëve të lëna nga individë të spikatur, Voc Deda kokrron dhe ndonjë detaj rrëzëllitës që plotëson mungesën e ndonjë “myhyri” në gjymtyrët e brishtë të një krijese që josh ashikët fatlumë.

Libri “Historiku i vëllazërisë” është më tepër se doracak. Është më shumë se sa një manual gjërësisht i nevojshëm. Për ta patur diku pranë Biblës e pranë Kanunit të Maleve të Mëdha. Për të qenë një këshillues elitar për ata që jetojnë e për ata që vijnë. Në hapësirat e librit të vëllimshëm mjaftueshëm, vëren se autori ka gërmuar deri atje ku ka vetëm shkëmb monolit, për të nxjerrë e për ta hedhur në letër origjinën e lisit të gakt të vet, e thënë ndryshe; fisit me rrënjë të thella, degë e rrema. Pjesë e rëndësishme e këtij vëllimi është dhe saktësimi dhe portretizimi i riteve, zakoneve që e nderojnë fisin, tipologjia e secilës brezni të marrë veçmas, apo refleksionet e pasurive të luajtshme ose jo, siç është dhe evidentimi i “gradës” së shkollimit e niveli i qytetërimit të individëve që përbëjnë fisin.

“Historikun e vëllazërisë” e pason “Historiku i familjes” që është derivat i të parit e plotësues me detaje që jo se i mungojnë librit pasardhës, i 12-ti në turrën e librave kompletues të “Sagës dukagjinase”, por cilësohen si partitura në kompozimin e një simfonie të plotë, me

jehonë që shtegton larg, në hapësirë gjeografike e poaq në zgafellat e kohërave në vlim. Harku përbashkues i gjyshit të largët me atë të nipit e mbesës së regjistruar vetëm disa javë para së revistës sonë daljes nga “furra” e shtypshkrimit, ndriçohet me inkadeshencë qetësuese deri në afirmim vlerash. Në këtë libër “lëçitësi” gjen më shumë dritë. Librit nuk i mungon as jermi. Degë të rëndësishme i janë shkëputur familjes së madhe në kalvarin e moteve. Mungesat plotësohen por gjurmët mbeten. Autori ngulmon ta bëjë me dije lexuesin e vet se emblema e familjes së tij ka qenë është e mbetet pikë referimi për afër e për larg.

Libri që përmbyll kollonën “Thesare dukagjinase” është i 13-ti në menyne e librave me të cilën “ushqehën” lexuesit e Voc Dedës. Jo vetëm pse është dëshira jonë, por janë të gjithë gjasat që ky libër të mos ketë tagrin përmbyllës të sagës në fjalë. “Ftesë për dituri” është më tepër se shtrat i ngrohtë për t'i mbajtur luçide perçinat e memories. Janë të shumta, nuk ngutemi po t'i cilësojmë universale, fushat e dijeve në shpalimin e magjishëm të tyre. Autori vihet në rolin e bebisiterit për t'jua mësuar e ngulitur në mendje lexuesve të vet dijet universale pa anashkaluar dhe ato që konsiderohen ndihmëse e kanë mision plotësues të pararendësave të veta. Psikoloigjisë, e sidomos dijeve specifike të kibernetikës, u përkushtohet Voc Deda, pasi sipas tij, një individ i “armatosur” me këto “almise”, nuk e ka të vështirë jo të vegjetojë e të mbijetojë, por dhe të jetë i suksesshëm. E thënë troç, të jetë dikushi e jo askushi.

Në “Ftesë për dituri”, vënd të rëndësishëm zënë edhe dijet për gjenezën, rritjen e vrullshme e harlisjen e hiterlandit metropolitan, pjesë integrale e të cilit është autori i “Sagës dukagjinase”. Kjo fushë dijesh, bëhet më e plotë kur njihesh me fatet e mëkatet e 33 ish kryemnistrave të Shqipërisë Londineze. E përdor këtë cilësor me dhëmbje përta kohë që vendi im mbetet një Piter Pan nën pushtetin e konvulsioneve hemoragjike. Autori jo vetëm nuk ju bën bisht, përkundrazi i hedh në telajon e krijimit ngjyrat e ndezura që sendërtojnë atlasin e përditshmërisë në të cilën përshkohemi ditë pas dite e stinë pas stine, me sharmin që përshfaqin normat e reja të sjelljes, përafritimit, bashkjetesës në çift e në grup, pa asfarë mbetje hatri me amë përkatësinë a cilësimin “tjetri”. Sonda për dijet në duart e Voc Dedës përshkohet në thellësi të frikshme. Në këtë libër ka zbërthime e përcaktime të monumenteve të arketipit njerëzor si “Kalendat greke”, “Kutinë e Pan-

dorës”, “Aventurat e Ulksit”, “Aisbergun”, “Mitin e Sizifit” e “Thembra e Akilit”, për të mos e bërë më të gjatë listën e eventeve me koracë të patjetërsueshme.

Në mbyllje të kësaj kronike sintezë e rrugëtimit letrar të Voc Dedës mbërrihet në përfundimin se ; numri trembëdhjetë i librave me tematikë interesante e të larmishme, e vendos autorin në baulen në të cilën nuk mund të mbarten shumë visare. Vokopulari i njohurive universale të krijuesit dukagjinase, shkodran e shqiptar, shpalimin e vet e ka dinjitoz dhe të admirueshëm. Voc Deda kultivon në librat e tij shije të hollë në përceptimin e jetës së përditshme, dhe të grish të rrahësh ato rrugë e rrugina prej kah dilet më kollaj aty ku e drejta dhe e arsyeshmja rrinë bashkë, kinse janë të pandashme nga njëra-tjetra.

Po pse gjithë ky shirok e kjo puhizë në librat e pafund të autorit që identifikohet me thesaret dukagjinase? Përgjigja i vjen në majë të buzëve çdo lexuesi të vëmendshëm të korpusit shkrimor të narratorit me origjinë nga Dukagjini. Autori e ka plotepërmajë lëmin e dijeve e hambarin e arsytetimeve, në bazë të të cilave gjendet në çdo rast e kurdoherë argumenti i pakundërshtueshëm. Dhe këtë shumës dijesh dhe arsytimesh, autori ka dëshirë t'i japë fortësinë e një guri të rëndë. Ai stërvitet të ta ngjithë në majën e pjerrinës që ka përpara atë gur. Do ta ketë apo s'do ta ketë fatin e Sizifit? Le të mendojë lexuesi i specializuar i Voc Dedës për këtë kah!

Një analizë të vëmendshme meriton edhe njëri nga librat e sagës së gjatë “Thesare dukagjinase”. Titullohet “Historiku i Vëllazërisë”. Këtu autori Voc Deda ndalet si çdo udhëtar me përvojë kur i duhet për me ngjithë një të përpjetë të lodhshme. Merr frymë thellë. Yryshin e mënjanon. Sjell nëpërmend breza njerëzorë dhe etapa kohore ndër të cilët ata u përshkuan. Autori numëron gjurmët. Ato janë aq të ngjashme ndërvedi. Kanë një mision të përbashkët. Të mbajnë në këmbë, lisin e gjakut me çdo çmim e sakrificë. Përpos gjurmëve të lëna nga individë të spikatur, Voc Deda kokrron dhe ndonjë detaj rrëzëllitës që plotëson mungesën e ndonjë “myhyri” në gjymtyrët e brishtë të një krijese që josh ashikët fatlumë.

Libri “Historiku i vëllazërisë” është më tepër se doracak. Është më shumë se sa një manual gjërësisht i nevojshëm. Për ta patur diku pranë Biblës e pranë Kanunit të Maleve të Mëdha. Për të qenë një këshillues elitar për ata që jetojnë e për ata që vijnë. Në hapësirat e librit të vëllimshëm mjaftueshëm,

vëren se autori ka gërmuar deri atje ku ka vetëm shkëmb monolit, për të nxjerrë e për ta hedhur në letër origjinën e lisit të gakt të vet, e thënë ndryshe; fisit me rrënjë të thella, degë e rrema. Pjesë e rëndësishme e këtij vëllimi është dhe saktësimi dhe portretizimi i riteve, zakoneve që e nderojnë fisin, tipologjia e secilës brezni të marrë veçmas, apo refleksionet e pasurive të luajtshme ose jo, siç është dhe evidentimi i “gradës” së shkollimit e niveli i qytetërimit të individëve që përbëjnë fisin.

“Historikun e vëllazërisë” e pason “Historiku i familjes” që është derivat i të parit e plotësues me detaje që jo se i mungojnë librit pasardhës, i 12-ti në turrën e librave kompletues të “Sagës dukagjinase”, por cilësohen si partitura në kompozimin e një simfonie të plotë, me jehonë që shtegton larg, në hapësirë gjeografike e poaq në zgafellat e kohërave në vlim. Harku përbashkues i gjyshit të largët me atë të nipit e mbesës së regjistruar vetëm disa javë para së revistës sonë daljes nga “furra” e shtypshkrimit, ndriçohet me inkadeshencë qetësuese deri në afirmim vlerash. Në këtë libër “lëçitësi” gjen më shumë dritë. Librit nuk i mungon as jermi. Degë të rëndësishme i janë shkëputur familjes së madhe në kalvarin e moteve. Mungesat plotësohen por gjurmët mbeten. Autori ngulmon ta bëjë me dije lexuesin e vet se emblema e familjes së tij ka qenë është e mbetet pikë referimi për afër e për larg.

Libri që përmbyll kollonën “Thesare dukagjinase” është i 13-ti në menyne e librave me të cilën “ushqehën” lexuesit e Voc Dedës. Jo vetëm pse është dëshira jonë, por janë të gjithë gjasat që ky libër të mos ketë tagrin përmbyllës të sagës në fjalë. “Ftesë për dituri” është më tepër se shtrat i ngrohtë për t'i mbajtur luçide perçinat e memories. Janë të shumta, nuk ngutemi po t'i cilësojmë universale, fushat e dijeve në shpalimin e magjishëm të tyre. Autori vihet në rolin e bebisiterit për t'jua mësuar e ngulitur në mendje lexuesve të vet dijet universale pa anashkaluar dhe ato që konsiderohen ndihmëse e kanë mision plotësues të pararendësave të veta. Psikoloigjisë, e sidomos dijeve specifike të kibernetikës, u përkushtohet Voc Deda, pasi sipas tij, një individ i “armatosur” me këto “almise”, nuk e ka të vështirë jo të vegjetojë e të mbijetojë, por dhe të jetë i suksesshëm. E thënë troç, të jetë dikushi e jo askushi.

Në “Ftesë për dituri”, vënd të rëndësishëm zënë edhe dijet për gjenezën, rritjen e vrullshme e harlisjen e hiterlandit metropolitan, pjesë integrale e të cilit është au-

tori i “Sagës dukagjinase”. Kjo fushë dijesh, bëhet më e plotë kur njihesh me fatet e mëkatet e 33 ish kryemnistrave të Shqipërisë Londineze. E përdor këtë cilësor me dhëmbje përta kohë që vendi im mbetet një Piter Pan nën pushtetin e konvulsioneve hemoragjike. Autori jo vetëm nuk ju bën bisht, përkundrazi i hedh në telajon e krijimit ngjyrat e ndezura që sendërtojnë atlasin e përditshmërisë në të cilën përshkohemi ditë pas dite e stinë pas stine, me sharmin që përshfaqin normat e reja të sjelljes, përafritimit, bashkjetesës në çift e në grup, pa asfarë mbetje hatri me amë përkatësinë a cilësimin “tjetri”. Sonda për dijet në duart e Voc Dedës përshkohet në thellësi të frikshme. Në këtë libër ka zbërthime e përcaktime të monumenteve të arketipit njerëzor si “Kalendat greke”, “Kutinë e Pandorës”, “Aventurat e Ulksit”, “Aisbergun”, “Mitin e Sizifit” e “Thembra e Akilit”, për të mos e bërë më të gjatë listën e eventeve me koracë të patjetërsueshme.

Në mbyllje të kësaj kronike sintezë e rrugëtimit letrar të Voc Dedës mbërrihet në përfundimin se ; numri trembëdhjetë i librave me tematikë interesante e të larmishme, e vendos autorin në baulen në të cilën nuk mund të mbarten shumë visare. Vokopulari i njohurive universale të krijuesit dukagjinase, shkodran e shqiptar, shpalimin e vet e ka dinjitoz dhe të admirueshëm. Voc Deda kultivon në librat e tij shije të hollë në përceptimin e jetës së përditshme, dhe të grish të rrahësh ato rrugë e rrugina prej kah dilet më kollaj aty ku e drejta dhe e arsyeshmja rrinë bashkë, kinse janë të pandashme nga njëra-tjetra.

Po pse gjithë ky shirok e kjo puhizë në librat e pafund të autorit që identifikohet me thesaret dukagjinase? Përgjigja i vjen në majë të buzëve çdo lexuesi të vëmendshëm të korpusit shkrimor të narratorit me origjinë nga Dukagjini. Autori e ka plotepërmajë lëmin e dijeve e hambarin e arsytetimeve, në bazë të të cilave gjendet në çdo rast e kurdoherë argumenti i pakundërshtueshëm. Dhe këtë shumës dijesh dhe arsytimesh, autori ka dëshirë t'i japë fortësinë e një guri të rëndë. Ai stërvitet të ta ngjithë në majën e pjerrinës që ka përpara atë gur. Do ta ketë apo s'do ta ketë fatin e Sizifit? Le të mendojë lexuesi i specializuar i Voc Dedës për këtë kah!

**Përgatitë nga
Dashamir Cacaj, poet**

TRADITA MUZIKORE GJAKOVARE

PROMOVOHET NË GJAKOVË LIBRI “TRADITA MUZIKORE GJAKOVARE” E STUDIUESIT DHE MUZIKOLOGUT BEHAR ARLLATI

Në Pallatin e Kulturës “Asim Vokshi” në Gjakovë u bë promovimi i librit me titull “Tradita muzikore në Gjakovë” e autorit Behar Arllati, profesor i artit muzikor dhe muzikolog i njohur, në të cilin dokumentohen shumë të dhëna, duke pasqyruar në mënyrë krejtësisht të re traditën muzikore të qytetit të Gjakovës. Njëherit kjo vepër, është e para e këtij lloji që me elemente të detajuara evidenton përshkrimin e jetës muzikore të këtij qyteti.

Gjakovari i “thekur”, profesori i etnologjisë dhe folklorit Behar Arllati, është i dashuruar pas qytetit të vet Gjakovës, e cila me edukimin dhe kulturën e saj, ka nxjerrë artistë dhe mendje të ndritura, duke prodhuar art dhe duke qenë gjithmonë pionierë të së resë, si dhe përparimit në çdo fushë të jetës.

Behar Arllati është një ndër pedagogët më të shquar në Shkollën e muzikës “Prek Jakova” në Gjakovë, ku me punën e tij profesionale ka marrë pjesë në shumë evenimente ndërkombëtare si në Kosovë, Shqipëri, Itali, Belgjikë etj.

Ai është jo vetëm një pasionant dhe studiues i muzikës, por dhe një ndër njohësit nga më të mirët i traditës muzikore popullore qytetare për mbarë trevat shqiptare, i cili është në pritje të mbrojtjes së titullit Prof. Dr. Etnologji-Folklor. Në solemnitetin e organizuar me këtë rast, pasi i uroi dhe i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrjen, për veçorinë dhe brendësinë e këtij libri, foli ish nxënësi e studenti i prof. Arllatit, që në këtë vepër ishte recensent, Meriton Ferizi, drejtor në Drejtorinë e Kulturës në Komunën e Gjakovës, i cili bëri një përmbledhje për një prezantim tërësisht të ri të traditës muzikore gjakovare, përfshirë këtu edhe ndikimin e traditës kulturore muzikore qytetare nga Shqipëria në Gjakovë.

Behar Arllati vitin e shkuar u paraqit para lexuesëve me botimin e parë me monografinë me titull “Mazllum Mejzini, jeta, vepra dhe roli i tij në traditën muzikore gjakovare”.

“Tradita muzikore gjakovare” është botimi i tij i dytë dhe autori po përgatitet që këtë vit të nxjerrë nga shtypi veprën e tij të tretë kushtuar krijuesit dhe artistit shqiptar Xhavit Xhepa, bashkëshortit të artistes së madhe Margarita Xhepa.

Në emër të profesorit dhe muzikologut të njohur shkodran Ferid Bala, me ftesë të Prof. Behar Arllatit, pata privilegjin që të jem i pranishëm në këtë promovim, i autorizuar nga vetë profesor Bala, i cili për arsye shëndetësore nuk ishte i pranishëm.

Vepra e profesorit dhe muzikologut Behar Arllati, vjen si një rezultat i një pune shkencore 25 vjeçare, me ekperiencë të gjatë artistike me amatorë dhe profesionistë të Gjakovës dhe më gjërë, e cila tani është në duart e publikut.

Që në rreshtat e parë ndjehet dashuria e madhe që përçon autori për vlerat e

trashëgimisë Gjakovare. Ai me durim ka marrë në analizë dhjetra figura artistike, në fushat e ndryshme të artit gjakovar si: këngëtarë, kantautorë, kompozitorë dhe poetë.

Ka hulumtuar me mund të madh, duke gjurmuar në pluhurin e harresës, e duke ringjallur përsëri edhe ato emra që për shumëkënd janë të harruar dhe të lënë në një anë.

Ai merr në analizë, muzikën e tyre, poezinë dhe interpretimin, duke u munduar që veprimtarinë e tyre ta analizoi në kohë dhe perjudha të caktuara. Në studimin e tij, ndjehet profesionalizmi shkencor që e përshkon.

Në këtë promovim kishin ardhur për ta falenderuar dhe nderuar shumë dashamirës nga Gjakova, personalitete të artit dhe kulturës, poetë e muzikantë të shumtë, krijues dhe këngëtarë të njohur të këngës shqipe, kolegë e miq nga Gjakova, Prishtina, Presheva, Shkodra, Tirana,

konsideratë u shpreh: “Jam shumë i privilegjuar që jam recent i këtij libri të prof. Behar Arllatit, të cilit punën ja njoh shumë më tepër prej që kam qenë gjashtë vjet student i tij dhe më ka përgatitur për fakultet në lëndët profesionale.

Libri ka vlera shumë të mëdha jo vetëm për Komunën e Gjakovës, por për gjithë shqiptarinë, sepse është një material voluminoz që paraqet fakte që nga fundshekulli i 18, prej muzikës së parë gjakovare, deri në ditët e sotme ku përfshihen shumë figura që profesori i ka nxjerrë në pah përmes një pune 25 vjeçare, që na bën të ndihemi të lumtur dhe të mendojmë për të punuar më shumë, për të nxjerrë vlerat e mëdha që i ka populli ynë, të cilat janë krijuar prej qindra vitesh”.

Më pas një opinion për këtë takim i morëm edhe legjendës së këngës kosovare këngëtarit Ismet Peja.

“Ishte një kënaqësi e madhe e imja që

ftuar në këtë promovim dhe u prezantova me kënaqësinë më të madhe kur pash një histori që e preka me dorë, hala pa e lexu librin. Në pika të shkurtra preka veprimtarinë dhe kulturën shqiptare, sidomos këngët elbasanase, korçare, shkodrane dhe gjakovare.

Sigurisht edhe pasi ta lexoj librin do të mësoj edhe më shumë se deri sot çka kam ditë për kulturën, për Isuf Myzyrin, për Qamilin e Vogël, për Imer Rizen, për Bik Ndojën e shumë të tjerë, sepse kënga ka qenë para plumbit dhe para pushkës, ambasador shumë i mirë për çështjen e kombit shqiptar, qoftë ajo popullore, dashnie, elegjiake, kreshnike, e dëshmorëve të luftës së fundit. Jam shumë i lumtur dhe i kënaqur që isha pjesë e këtij takimi”.

Profesor Rexhep Abazit nga Medvegja i morëm opinionin e tij ku përmes emocioneve tha: “Ishte kënaqësi që mora pjesë në këtë eveniment, sepse kur lind



Mali i Zi, Prizreni, Peja, Istogu e deri nga Amerika e largët, që me praninë e tyre e madhështuan këtë aktivitet, duke vlerësuar kontributin e autorit në ruajtjen e një pjese të rëndësishme të trashëgimisë muzikore shqipe.

Mund të përmendim në këtë pjesëmarrje disa nga emret më të nohur të artit muzikor në Kosovë si: Personazhi më i vjetër i gjallë, i përfshirë në libër i pranishëm, Asllan Kryeziu (1932), Bashkim Lajçi nga Instituti Albanologjik i Kosovës, Ismet Peja, Prof. Dr. Nesim Vala, tre nga katër Anëtarët legjendarë të Rock Grupit të parë mbarëshqiptar të krijuar që në vitin e largët 1964 në Gjakovë me emrin “Farazimus”, si dhe shumë personazhe të tjerë.

Në përfundim të këtij aktiviteti ne mundëm që të marrim disa opinione nga disa pjesëmarrës të nderuar:

I pari që intervistua ishte drejtori i drejtorisë së kulturës në Komunën e Gjakovës z.Meriton Ferizi, i cili me shumë

përjetova këto momente të paharrura në promovimin e librit “Tradita muzikore në Gjakovë” në të cilin bëhet fjalë jo vetëm për këngën gjakovare, por mbarë shqiptare.

I uroj prof. Beharit suksese dhe jetë të lumtur dhe të na gëzojë përsëri me këto vlera të spikatura në Gjakovën e Ymer Rizës, Qamilit të Vogël, Mazllum Mejzinit dhe shumë e shumë artistëve të tjerë që e kanë përjetësuar emrin e tyre përmes këngës gjakovare.

Përmes jush përshëndes shkodranët e qejfit, dijes dhe kulturës, veçanërisht Bik Ndojën, Shyqyri Alushin, Naile Hoxhën, Bujar Qamilin dhe shumë të tjerë që janë vlera për Shkodrën dhe gjithë Shqiptarinë”.

Një intervistë të shkurtër i morëm edhe rapsodit dhe këngëtarit popullor, si dhe autor i shumë teksteve e këngëve nga të gjitha rajonet shqiptare, fjalëve të urta popullore dhe shumëçka në karrierën e tij z.Xhemali Berisha: “Sot isha i

një libër, është njësoj si lindja e fëmijës. Po mendoj se edhe kjo vepër mund të krahasohet si një lindje e madhe për njerëzinë, pasi kjo nuk i mbetet vetëm familjes së autorit, apo vetëm një rrethi lokal të ngushtë. Kjo është një plotësim i mozaikut të kulturës njerëzore në përgjithësi dhe një kontribut i kulturës shqiptare në kulturën njerëzore në mbarë botën.

Prandaj ishte kënaqësi, sepse vjen nga një intelektual i mërëfilltë dhe i përgatitur për këtë fushë, të cilën e ka përpunuar, e ka lëvruar dhe ka dhënë një material në të cilin gjeneratat e ardhshme do të gjejnë mundësinë që të studiojnë dhe të krijojnë në bazë të saj edhe vepra të reja me vlerë të tillë.

Pata privilegjin që në këtë promovim të marr një opinion edhe nga shqiptaro-amerikania, veprimtare, krijuese, poete, si dhe dëshmitare e luftës së fundit në Kosovë, Rita Salu e dekoruar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë

me çmimin “Nënë Tereza”: “Përmes mbartjes së emocioneve, lodhjes nga udhëtimi prej 36 orësh nga Amerika për të qenë në rivarrimin e herojt tonë Isa Bole-tini, kur më telefonoj znj. Migena Arllati dhe më tregoi se do të bëhej promovimi i librit, ju them të drejten bëra përpjekje për të qenë këtu, për një dëshirë, nga se Gjakova është zemra e kulturës shqiptare, e në përgjithësi zemra e kulturës Dardane.

Më vjen mirë që arrita të jem edhe unë pjesë e këtij evenimenti, pasi këtu kishte pjesëmarrje të gjërë, respektivisht nga të gjitha trevat, si edhe Shkodra, përfaqësuar nga ju. Unë i dua këngët e Shkodrës, më flejné për zemër”.

Një moment tjetër i bukur, por dhe emocionues, ishte kur bashkëshortja e autorit të librit znj. Migena Arllati u shpreh e kënaqur për arritjet e bashkëshortit të saj të nderuar Beharit. “Ne në përgjithësi jemi familje që i lëvrojmë letrat dhe merremi me studime, me shkrime e të tjera me radhë, jo vetëm se unë edhe Behari kemi ndërtuar të njëjtën familje, por mbajmë edhe të njëjtin profesion, sepse të dy jemi mësimdhënës. Ne, përveçse mësimdhënës jemi edhe krijues dhe studiues. Kjo na kompletton në kuptimin e plotë të fjalës intelektual.

Jam shumë e kënaqur që tek bashkëshorti im kam gjetur arsimdashësin, krijuesin dhe studiuesin, dhe po ashtu edhe tek vetvetja kam ndërtuar të njëjtat ndjesi. Për ne si çift bashkëshortësh nuk mjafton, apo nuk përfundon me kaq, pasi ne kemi detyrë kryesore dhe primare rritjen e fëmijëve, duke synuar që edhe tek ata të kemi ndjesinë që t’i bëjmë edhe ata artistë, të shkruajnë edhe ata.

Mund të them lirisht se jemi familje krijuesish sepse edhe vajza jonë ka botuar një libër në vitin e kaluar, djali është pianist, i ngjan të atit e kështu me radhë. Domethënë kultivojmë artin në atë prizëm që ne e ndjejmë veten artistë.

Kjo punë e finalizuar sot e bashkëshortit tim, librit “Tradita muzikore në Gjakovë” është një punë aq voluminoze sa askush nuk mund ta kuptojë në mënyrën më të drejtpërdrejtë sa e kuptoj

prandaj edhe kjo punë që sot u promovua, për ne si familje është një kontribut shumë i madh. Unë e shoh këtë libër jo vetëm si kontribut i Beharit, por i gjithë familjes sonë.

Pas përfundimit të këtij takimi, Komuna e Gjakovës shtroi një drekë për pjesëmarrësit, ku edhe aty munda të intervistoj disa prej tyre.

I pari që u prononcua ishte autori i librit “Tradita muzikore në Gjakovë” prof. Behar Arllati.

Z. Behar, shumë personalitete të artit dhe kulturës ju nderuan dhe ju vler-suan, ashtu siç i keni nderuar dhe vler-suar edhe ju në librin tuaj. Si ndjeheni ju sot pas ktij vlerësimi: “Është

diçka tjetër kur e respekton dike tjetër, por diçka shumë e madhe është kur e përjetova vetë, kur dikush të respekton. I falenderoj sinqerisht të gjithë ata që më kanë ndihmuar dhe kanë personalisht që morët mundimin nga Shkodra të vini këtu ta lexoni fjalën e prof. Feridit, por dhe të shkruani për këtë eveniment. Falenderoj shumë edhe drejtorin e Drejtorisë së Kulturës në Komunen e Gjakovës z.Meriton Ferizi si recensionist në këtë libër, si dhe të gjithë pjesëmarrësit që ishin sot këtu, shumica prej të cilëve ishin familjar të personazheve që dikur kanë qenë mbartës të traditës së Gjakovës.

Në fakt tradita e Gjakovës është e lidhur shumë ngushtë me Shkodrën dhe këtë unë e kam thënë edhe herë të tjera. Kjo është e pamohushme. Shkodra ka qenë ajo që e ka mbajtur Gjakovën të gjallë nga aspekti kulturor e pse jo edhe ekonomik. Ne themi se kur ta kesh një kojshi të mirë, është një pasuri, është sikur të kesh “një kal me para (flori)”. Ne kemi patur fatin që kemi pasë Shkodrën afër si kojshi dhe duke filluar që nga tregtia e Çarshisë së madhe në shekujt 17-19, kanë bërë që kultura dhe këngët tradicionale të transportohen prej Shkodrës në Gjakovë, apo nga Gjakova në Shkodër edhe pse më pak.

Në libër e kam pasqyruar, madje edhe shumë familje shkodrane, si familja Çoba e shumë familje të tjera që kanë kontribuar, sidomos Palok Kurti, i cili ka

ishte vetë muzikant profesionist, i pari që ka shkruar këngët me nota dhe muzikë artistike të kultivuar si kompozitor.

Moria e fakteve dhe personaliteteve që kanë kontribuar në krijimin e kësaj tradite të Gjakovës është aq e madhe, sa që njeriu bie nganjëherë në konfuzion që cilin ta vendosim më para dhe cilin më prapa, kush ka më shumë merita, kush ka më pak, menjëfjalë, si tërësi, të gjithë kemi vënë nga një gur sado të vogël në një kala si ajo e Rozafës, ndoshta edhe më e madhe kjo kalaja e traditës muzikore që ka Shkodra edhe Gjakova, natyrisht më të vogël se Shkodra, mirëpo shumë të fuqishme për zonat e Kosovës.

Unë e kam thënë edhe më heret, nëse Shqipëria e ka humbur Kosovën, Kosova ka patur fatin e mirë që ka pas Gjakoven, e cila nuk e la me u asimilu. Fakt për këtë ka jo pak dhe, ndërsa Sulltan Muratit i është bërë tyrbe në Prishtinë e Gazimes-tan, Mehmet Ali Pashë Maxharit ne ia kemi bërë varrin dhe ia kemi ruajt. Ruajtja e varrit dhe e varrezave është kulturë më e madhe se me e bërë tyrbe.

Një privilegj tjetër ishte për mua, kur arrita që t’i marr një opinion edhe personazhit më të vjetër, i përfshirë në këtë libër, Asllan Kryeziu.

“Me Beharin jam njohur vonë, por babën e tij e kam njohur shumë heret. Mosha ime, koha ime kanë qenë shumë adekuate në atë kohë, sepse edhe ai ka qenë më i vjetër se unë. Mirpo ai ka punuar shumë për kulturën, ka qenë një aktor i hatashëm.

Behari e ka hulumtuar shumë punën time, pasi jam edhe një prej harmonistëve të parë që kam shkruar nëpër dasma dhe kemi bërë ahengje. Tani unë kam një vullnet të madh për ta lexuar librin e Beharit, megjithse diçka përciptas e pash edhe nga reagimi i personazheve që erdhën këtu në promovim, ato që e duan kulturën shqiptare, pa marrë parasysh se i cilës trevë është.

Librin që Behari ka bërë kohë më parë për Mazllum Mejzinin, të cilin unë e çmoj shumë si kantautor, autor i shumë teksteve, si instrumentist, pasi unë kam bërë muzikë me të, unë i kam rënë har-

kaluar moda, ndaj po përpiqem të them diçka të qartë dhe shkurt: Kënaqësi të posatshme për ne mësuesit e parë, kur nxënësit e nxënësve tonë arrijnë të bëjnë një gjë të mirë. Kur bëhen koncerte të muzikës klasike për të cilët i kemi mësuar, po kënaqena, pasi po më duket sikur po më hiqet nga një rrudhë. Kënaqësi e posaçme që nuk po mbesin në harresë, është nisur mbarë, filli është i mbarë dhe uroj që të vazhdojë edhe me brezat e ardhshëm. Më vjen mirë që edhe ju kujdeseni për t’i kompletu këto vlera, duke pasqyruar të vërtetën, jo të kamuflueme, jo të luajtur. Të them të vërtetën është bërë punë e madhe prej njerëzve të kulturës dhe arsimit, për ta ruajtur dinjitetin tonë kombëtar dhe njerëzor, që është shumë e rëndësishme. Ju falenderoj që erdhët në këtë promovim dhe dua t’ju them se unë jam nipi i Avni Mulës. Prejardhja e familjes time është nga Shkodra, të cilët kanë qenë të detyruar prej Vezirit të Shkodrës të largohen prej aty. Gjithmonë e kemi ndjerë në shpirt afërsinë dhe nevojën për komunikim e për çdo gjë”.

Gjatë një bisede me mikun tim, “Mjeshterin e Madh” Bujar Qamili, duke diskutuar rreth këtij shkrimi, më kërkoi që t’i lija një hapsirë për të thënë dy fjalë për mikun e tij Behar Arllati. Dhe unë pa dyshim ja krijova me kënaqësi këtë hapsirë: “Të japësh një opinion për muzikologun Behar Arllati nuk do të ishte e vështirë, pasi për këtë flet karriera e tij disa vjeçare, por të flasësh për Beharin si njeri vështirësia fillon në qëmtimin e fjalëve të duhura që do të shërbenin si penelata në skicimin e portretit e tij të mrekullueshëm shpirtëror e fizik, gjë që nuk do të hezitoja ta bëja sikur të lejonin hapësirat e këtij shkrimi.

Kam pasur fatin ta njoh nga afër këtu në Shkodër në një promovim libri të prof. Ferid Balës, ku ai mbajti një kumesë shumë të rëndësishme dhe emocionuese.

Në një kafe ku ju më keni ftuar së bashku me prof. Arllatin kemi biseduar për vlerat që ka kënga popullore shkodrane dhe ajo kosovare.



unë, sepse unë e di se me sa vullnet, me qindra net, ai ka qëndruar i mbyllur në studion e tij, duke punuar, duke harruar orarin e drekës, darkës, obligimet familjare dhe të tjera me radhë.

Sigurisht e kuptoj dhe e arsyetoj, pasi krijuesi shpesh herë është më kryeneç se sa familjari, apo se sa indiviti në familje,

qëndruar një vit në Gjakovë dhe është i pari që ka themeluar Bandën muzikore të Gjakovës e që ka shkruar edhe një marsh kushtuar Gjakovës “Lamtumirë mori Gjakovë”, por puna më e madhe e Palok Kurtit është sjellja e Ahengut shkodranë në Gjakovë. Ai i ka mësuar muzikantët dhe ka bërë një punë shumë të madhe, pasi ai

monikës, ai mandolinës dhe formuam shoqërinë “Hajdar Dushi”.

Intervistën e fundit e zhvilluam me një nga mësuesit e përë të muzikës në Gjakovë z.Aliriza Rraci, e cila ishte një ndër intervistat më të arta ku shkurtimisht ai tha: “Në rrethanat e sotme zgjatja e bisedave apo kementeve iu ka

I uroj prof. Behar Arllatit jetë të lumtur dhe e falenderoj sinqerisht për këtë vepër me rëndësi faktografike që pasuron dijet mbi folklorin shqiptar”.

Ramazan Çeka

Instrumentet muzikore ilire dhe Pani Hyu i grigjave e kullotave, muzikant, instrumentist e satir i lashtë i gadishullit

- ME RASTIN E FESTIVALIT FOLKLORIK KOMBËTAR, TË GJIROKASTRËS 2015 -

Thuhet se muzika zhytet thellë në pre-histori bashkë me njeriun dhe kështu ne njohim shpikiet e instrumentet e lashta muzikore. Vërtetohet se instrumentet e para ishin prej guackash, prej kockash e të tjera. Instrumentet e quajtura si kordofone, si lira e harpa ishin në përdorim në Egjipt e pakta rreth viteve 2700-3000 p.e.r. Ashtu edhe lahuta me qime kali ishte e lashtë dhe vetë fjala lahutë e shqipes vjen nga “el aud” egjiptianishte, që lëshon za.

Si të gjithë popujt e grup fiset antike, nuk ka dyshim se edhe ilirët kishin instrumente muzikore dhe shoqëronin këngët me një muzikë të “frymëzuar nga muzat”. Poezitë epike i këndonin me za e recitonin me vargje aedët si Demodoku e Ekinea, ku tregonin histori, beteja, udhëtime-eksplorime, trimëri të lashta dhe vajtime, me veglat e tyre kordofone si tipi i lahutës, të kombinuara me fyej, flauta e të tjera. Këto këngë e kërcime këndoheshin në gosti, martesë, pritje miqsh dhe ceremoni mortore.

Si ilustrim, sjellim disa citime nga autorët antikë. Straboni, dëshmonte: “Dardanët, janë aq të egër sa edhe nën pleh bagëtish rrëmijnë gropa dhe aty rrojnë [Duhet interpretuar si mënyra e shtëpive ku në një pjesë jetonin njerëzit e në pjesën tjetër gjëja e gjallë. A L]; megjithkëtë muzikën nuk e lëjnë mënjatë, përkundrazi përdorin gjithmonë fyej e vegla me kordha”. (Geographica, VII, 7. “Ilirët dhe Iliria...”, f 155)

Atheneu, duke cituar një autor të hershëm Durin nga Samosi, shkruante: “... në një duel midis Olimpisë epirote dhe Euridikës maqedone, dyluftimi i Olimpisë shoqërohej nën ritmin e një daulleje dhe dallonte dy lloj kërcimesh / vallesh me ritme të ngadalshme dhe të ndryshueshme, kërcimin daktyl dhe kërcimin jambik molos ...” (Deipnosophistae, Lib. XIII, 560f 10; 623d 27)

Diodori i Siqilisë, përmend se kishte qenë Filipi, para Aleksandrit të Madh, ai që e kishte parapregatitur fushatën kundër Azisë e Persisë, madje kishte nënvizuar edhe rolin e muzikës, në ngritjen psikologjike të entuziazmit dhe optimizmit masiv popullor, kur shkruante: “Filipi, duke besuar se kishte mbështetjen e perendive gëzohej qysh më përpara se, Azia do të binte në duart e maqedonasve ... Ai urdhëroi që të bëheshin flajime madhështore dhe celebroid martesën e të bijës, Kleopatra, që e kishte me Olympinë, dhe që ia dha për nuse Aleksandrit mbretit të epirotëve, i cili ishte vëllai i Olimpisë. Për të tërhequr në këto festa një numër sa më të madh ai organizoi çfaqje muzikore dhe festa të shkëqyera, në të cilat ftoi edhe ftoi miqtë e vet edhe të huaj. Filipi, pruri të ftuar nga e gjithë Hellada dhe i porositi miqtë që të ftojnë edhe ata nga ana e tyre të gjithë rrethin e miqësisë që dëshironin; ai kishte ambicien të fitonte zemrat e helenëve dhe t’i përgjigjej me dinjitet nderit që i kishin bërë, duke e emëruar

kryekomandant i Helladës”. (Bibliotheca Historica, Lib. XVI, 91)

Zbulimet arkeologjike dhe studimet e fondit popullor, tregojnë se ka patur gjithfarë tipe fyejsh e instrumentesh të tjera prej druri, prej briri e kallami, kishte tipe bilbilash prej shelgu e deri edhe fyej prej shtogu, dhe tipe të ndryshme pipizaneshe. Ka patur tipe daullesh/lodrash, gjithfarë gajdeshe e defesh / dajresh. Ka patur shoqërime me kore grash e burrash, me polifoni, me gjithfarë pasthirmash, imitimesh e ritmesh. Nuk duhen harruar se ka parur edhe vegla me tinguj bakri e bronzi e të tjera.

Një informacion të çmueshëm, për vazhdimësinë na jep M. Barleti, kur shkruante: “Ndërmjet trimërive të tjera të ndritura të të vjetërve dhe lavdeve të të parëve, të cilat këndohen zakonisht nëpër gostira, sipas një zakoni të lashtë dhe ndoshta jo të përbuzhshëm, brezi i ri ka futur me mirënjohje sidomos ngjarjet e luftat e Skënderbeut”. (HS, bot. 1967, f 381-382)

Po nga Barleti kemi përshkrimin e një ceremonie mortore / gjamë kështu: “Mamica, pasi thirri sipas zakoni të gjindjes, shumë zonja e nderoi varrimin e burrit Tanush Muzaka për një kohë të gjatë me zi e lotë që s’pushonin as ditë as natë. Unë me plot të drejtë do të kujtoj se të vjetrit e kanë quajtur këtë Nenia. Dhe me të vërtetë të vjetrit e kanë patur zakon që, gjatë vajtimit, të përmendeshin jo vetëm trimëritë dhe veprat e shquara të të ndjerit, por edhe trimëritë e etërve dhe gjith kujtimet stërgjyshore dhe lavdet e lashta të familjes. Ky zakon ka qenë dikur aq fort në përdorim nga popuj të lindjes, sa që merreshin për këtë detyrë me rrogë gra të mësuar, të cilat t’i nxirnin lotët me këngët dhe xhestet e përva-jshme. Por tani, si shumë gjëra të tjera, kanë dalë nga përdorimi edhe vetë lotët”. (HS, f 342)

Këto vajtimet shoqëroheshin me fyell e lahutë, ku akoma sot vegjeton fjala për ngadalësi e monotoni: “si Nenia e Dushes”. Mundemi të vërejmë edhe veprimin e çensurës fetare, e cila i quante “zakone

të përbuzshme”, ish zakonet tradicionale të trashiguara nga paganizmi.

Nga mesjeta ne kemi pasur një traditë të pasur bashkëkohore evropiane, por atë e zhdukë e hodhi në regres e në orjentalizëm pushtimi turko-otoman. Kështu dokumentet tregojnë për organon e famshme të kishës katedrale të Shën Stefanit ose për kompozitorin me famë të Durrësit, Jan Kukuzelin, i cili kishte praktikuar edhe një sistem regjistrimi me nota të muzikës.

Një e metë e madhe e muzeumeve tona është se nuk ka përpjekje sa duhet për pavione të veçanta me veglat muzikore të gjetura në objektet e ndryshme të arteve, nuk ka përpjekje për prodhim imitimin e tyre të ri nga mjeshtrit popullor.

Mitologjia e helenizuar dhe e rregulluar nga mitografët helenë, kërkon ta sjellë dhe ta përvehtësojë komplet hyun Pani,



Basoreliev antik guri gjetur në teritoret ilire në Bosnje. Pani me brirë cjapi me këmbë dhie me mitologji me një lëkurë luani, me Pemën e Jetës etj dhe me veglën muzikore një tip flauti-siringa me varëse.

madje me origjinë primare nga Arkadia apo me origjinë primordiale nga Hyjnitë Qiellorë helenikë! Por, ndërkaq mitologët

modernë kanë vërejtur se kulti i satirit Pani, gjysëm cja e gjysëm njeri me brirë cja, ishte i përhapur dhe njihej në të gjithë gadishullin Ilirik/Hylli ose Evropa, siç do quhej me pas. Realisht, qysh heret disa nga autorët antikë të mirëinformuar, Hyu Pan e quanin hapur me origjinë të huaj e jo greke. (shih më poshtë)

Autoriteti, P. Grimal nënvizon: “Pan (Πάν) è un dio dei pastori e delle greggi, che sembra originario dell’Arcadia, benché il suo culto sia diffuso per tutta la Grecia e sia generalizzato anche al di fuori del mondo ellenico” = “Pan është një hy i barinjve dhe i grigjave, që shëmbëllen origjinarisht nga Arkadia, megjithse kulti i tij ishte i përhapur në të gjithë Greqinë, madje përgjithësisht edhe jashtë botës helenike”. (Enciclopedia dei Mit, bot. 1990, f 474)

Etimologjikisht gjuhëtarët mendojnë: “Il nome Πάν deriva dal greco paein, cioè “pascolare”, e infatti Pan era il dio pastore, il dio della campagna, delle selve e dei pascoli” = “Emri Pan derivon nga greqishtia paein, që do të thotë “ruajtës kullotash” dhe në fakt Pan ishte hyu i fushave, i pyjeve e kullotave”.

Mitologjia e Panit janë të shumta, ato ruajnë edhe ndryshime specifike në varësi të krahinave e vendeve të ndryshme, por megjithatë e ruajnë një emërues të përbashkët. Duke qenë gjysëm sqar e gjysëm njeri ai ka tipare komike e trashamani malok. Panin e paraqesin si sekso-man të pangpur, që lakmon veçanërisht nimfat e bukura të ujrave e pyjeve si, Driopa, Amadriada, lakmon vajzat e reja njerëzore, lakmon edhe seksin me dhi e dhën, diku edhe si biseksual e pederast e të tjerë. Duke patur karakteristikat e satirëve, si kërcimtar e valltar e të tjerë, ai argëtonte edhe vetë perenditë e Olimp, sidomos Dionisin e vetë Zeusin. Primitiviteti, çiltërsia e trashamania e përzierë edhe me një llapazanllëk të shfrenuar e bënë që Pani, të imitonte e përqeshte edhe vetë Zeusin, të kryesonte me leje ose pa leje, bisedimet në “Kuvendin e Zotave në Olimp”, madje edhe para vetë Zeusit! Njihet se me emrin e bëmat e tija



Amadriade e Pan: mosaico (I sec.). Napoli, Museo Archeologico Nazionale.



Dafni e Pan: scultura (II sec. a.C.). Napoli, Museo Archeologico Nazionale.



Pani , duke lajkatur nimfën ndihmuese pyjore Amadriada, mozaik; Pani duke i mësuar Dafnes flautin, skulpturë; Pani duke luajtur në Lirë, monedhë.

ka rrjedhur vetë termi “panik”!

Ndër autorët e shumtë antikë që shkruan për “Bëmat e Panit”, shquhet edhe “Volteri i antikitetit”, Lukiani nga Samosata. Fillimisht, Lukiani e rradhiste Panin si një nip i Dionizit me lidhje me Kadmin sirofenikas. Në një vend tjetër Lukiani e quan Panin, ndër zotat e ardhur në Olimp e madje si shumë të dyshimtë: “Mua më mori Hermesi dhe më vuri të rrinja pranë Panit, Koribantëve, Atisit dhe Sabazit – zota, të cilët nuk gëzojnë të drejta të plota në qiell dhe që janë mjaft të dyshimtë” ...

“Do të diskutohet në “Kuvendin e Zotave”, çështja e metekëve dhe e të huajve. Disa nga ne sillen paturpësisht! Për ta nuk mjafton që, duke qenë njerëz, u bënë perendira; jo, ata tani, duke mos u mjaftuar me atë që marrin vetë pjesë në mbledhjet tona dhe hanë e pijnë njëllor si ne – megjithëse janë gjysëm të vdekshëm, - kanë sjellë këtu në qiell shokët e shërbëtorët e tyre dhe i kanë regjistruar në Deferin e Perendive! Dhe tani ata i ndajnë me ne barabar dhuratat dhe theoret, kurse taksën e tyre si metekë as që na e paguajnë fare...”

“Dionizi, pasi fitoi pavdekësinë vepron si gjysëm i çmendur, pi që në mëngjes verë të pa holluar me ujë. Por ai na ka sjellë në Olimp tërë vllazërinë e tij dhe rron këtu bashkë me korin e vet, pasi bëri Hyjni Panin, Silenin dhe satirët, ca malokë të pagdhendur dhe në shumicën e tyre barinj dhish e dhensh, aq të shëmtuar sa s’shihen me sy. Pani është me brirë, tërë gjysmën e poshtme e ka si të cjaipit, ka një mjekërr një pëllëmbë të gjatë – shkurt dallohet fare pak nga një cjaip”; ...


Dhe ti o Zeus qysh duron që të vënë brirë dashi e cjaipi ...

[Lukiani, Vepra të Zgjedhura, “Ikaro-nenipi ose fluturimi përtej reve”, bot. 1979, f 53; “Kuvendi i Zotave”, f 14-15; f 18-19 e të tjera; Metekë, quheshin në Athinë të huajtë dhe popullsia e ardhur rurale blegtorale, si ta themi me një term të kohës së diktaturës enveriste, popullsia e papasaportizuar. Në një shkrim tonin, duke karakterizuar Demokracinë e Zanieve Anarkiste me Bathoren e Tiranës dhe gjuhën e kapardisjen e kapove të metekëve dhe vllazërisë në “Kuvendin e Arnautistanit”, kisha dalluar dy protagonistë, Hyun e Dhive, Berrave dhe Ulkëve,



Pani duke luajtur në flaut; Pani në botën baritore, monedhë argjendi

një legjendë si vëllai binjak i Arkadit; njihet edhe një tjetër legjendë akoma më primitive ku një bari në mal i quajtur Krati mbarsi një dhi dhe ashtu lindi Pani; një varjante tjetër thotë se, vetë Zeusi e



Hyu Pan, duke ndjekur shëmbëlltyrat e Kryehyjnorit Zeus...

mbarsi dhinë Beroe dhe kështu lindi hyu cjaip Egipan ose shkurt Pan; ka pastaj me dyzina aventura seksuale të Panit, ku nuk ka munguar pa u përfolur as besnikëria dhe përsëritshmëria e Penelopes, e cila ia kish dredhur Odiseut me Panin, gjatë kohës së mungesës së tij!

Është mjaft interesante se të gjitha format e arteve, e paraqesin Hyun Pan të rafiguruar si një muzikant, si instrumentist e si mësues i apasionuar i disa veglave muzikore antike.

Fillimisht teksti “Historia e Shqipërisë” (bot. 1959 e ribot. 1967, f 72 e f 110), kishte shprehur një hipotezë të tillë: “Perendi të njohura veçanërisht nga skulpturat dhe burimet e vona të shkruajtura janë: Pani, hyu i pyllit e i grigjës, i

greke e romake!

(T. Dhama, Fjalor i Mitologjisë, bot. 1987, f 188-199)

Ç’që ky censurim, konservatorizëm kundër liberalizmit?, apo se Zeusit tonë mandolinist nuk i pëlqente ky rival imoral e pervers, sepse i kujtonte veten vet?! Gjithsesi, tek e fundit këto perendi idhujtariste ndalohehin edhe me Qitap.

Bazuar mbi një bazoreliev guri të skalitur, të gjetur në Bosnje, ku paraqitet Pani me një flaut antik të quajtur siringa, ne besojmë se mund të ringrihet hipoteza se Hyu Pan, kishte edhe një mitologji me origjinë ilire e dardane.

Ne mendojmë në hipotezë se emri Pan lidhej me fiset baritore pellazge ilire Panone e Peone. Me kopetë me dhi lidhej edhe fshati Tragjasi e ndoshta edhe Progonati (Protogonos - Πρωτογόνος, “primo nato”). Ndoshta nga këto emra e nga territoret tona rrodhën sinonimet si fise baritore. Dhe kjo nuk ishte hera e parë, përsëmbull autorët antikë shënonin haptazi se, emri Gerion, rridhte nga Trinjaku Gerion, një ish pronar i madh kopeshë me qe e buaj, një basileus “i trefishtë”, baritor mitologjik i lashtë i Epirit, ku Herakliu ia grabiti atij në Epir, përballë ishullit Saseno, Kopetë e Gerionit dhe jo në Gjibraltar në Oqeanin Atlantik. (Shih Arriani, që citonte Hekateun e shek VI p.e.r., “Alexandri Anabasis”, Lib. II, 16;

Në mitologji njihet Triopi, mbreti i pellazgëve, të cilët nga Argosi kishin emigruar në ishullin Isa/Lesbos – Pellazgjia e më fund kishin pushtuar e ishin vendosur në Liki. (Diodori, B.H., Libri V, 81) Emri kishte lidhje me trefishin, po ashtu siç edhe “Dorët e Trefishtë”, të ndarë në tre fise etj; Te Homeri përmendej Aktori, me numërin e dyshët, dmth si vëllezër siamezë me një trup, dy kokë, katër këmbë e duar, siç edhe “Janusi i dyfishtë”. “Iliada”, bot. 1965, K. XXIII, v.756;)

Siç shihet, ishte ky variant bazë i Tre Gerionëve, më i hershmi i gadishullit tonë që u shërbeu helenëve për Tregime-Bëmat e Herakliut, duke e degdisur Gerionin me tre koka, gjashtë duar e gjashtë këmbë në “Fundin e Botës në Perendim. Si shëmbull ndoshta vlen edhe emri i fiseve ilire Tribale, që shënoi një sinonim për

tribalizmin, apo siç fiset ilire bastarne, për bastardhë etj.

Straboni shkruante: “Fiset panone janë breukët, andizetët, peirustët, mazedjtët e desidiatët që kanë për prijës Baton ... Dardania kufizohet me fiset maqedone dhe paione nga ana e jugut sikundër edhe me autariatët e dasaretët... Dardanë janë edhe galabrët... (cit)



1 Gara musicale tra Apollo e Maria: rilievu (V sec. a.C.). Atene, Museo Archeologico Nazionale.
2 Olimpo chiade pietà per Maria, che Apollo vuole accorciare mar: ritaglio in corniola (età greco-romana). Napoli, Museo Archeologico Nazionale.



Koncerte muzikore antike me dopioflaut, def / dajre dhe lire

Në autorët antikë gjen fise dardane edhe në Peoni te lumi Strimon, edhe në Arkadi, madje mitologjikisht po në Arkadia, na del edhe Dardani, i cili pastaj na emigron në Dardani - Frigji e Troadë. Në



Herakliu duke luftuar me trinjakun Gerionin, amforë shekulli VI p.e.r. Vini re se Gerioni i Trefishtë i Epirit, ka në mburoje “shqiponjën t’murrmen gjahtarë që e quajnë zeshkane” e Epirit të Zeusit Pellazgjik. (Shih Iliada. K. XXIV, v 387, ribot. 1979)

një monedhë edhe Dardani po ashtu si Pani na del muzikant që i bie lirës e të tjera.

Pergatitje nga Agron Luka



Monedhë argjendi, Basileusi Dardani dhe Lira e famshme

Berranin malok, që përhapte panikun dhe të zgjedhurën e tij, hyjneshën qytetarkën ezmere Çirrçe që çirrej dhe që kishte veti në t’i shndrronte njerëzit në derra ...]

Ka me dyzina varjante e pyllnaja mitologjike, për filiacionin e gjenealogjinë e Panit, ku fillimin e kanë edhe perenditë e vjetra Kroni e Rea, Urani e Gea, pastaj edhe Zeusi e Ibrisi e të tjera; ka një burim homerik, ku babai tij paraqitet Hermesi dhe nëna e tij nimfa Driopa; njihet edhe

shoqëruar rregullisht nga Nymfet, hyjneshat e burimeve”.

Pak më vonë me eksperimentet “me forcat e veta” dhe me historitë “makete”, me sa duket specialistët tonë interpretues u trembën dhe e censuruan Panin. Çuditërisht mitologët tonë nuk e përmendën më hipotezën e origjinës a miniumi prezencën ilire të Panit! Ata u mjaftuan vetëm ta përmendnin si “shpikës i fyellit” dhe si i përkatësisë mitologjike

Amazonat e ditëve tona, dëshmi e dinjitetit civil, promotore të së ardhmes progresiste të një kombi

(DUKE MEDITUAR RRETH LIBRIT “AMAZONAT E SHKODRËS” TË “MJESHTRIT TË MADH”FADIL KRAJA)

Të shkruash vërtet që nuk ka qenë, nuk është dhe as nuk do të jetë asnjëherë e lehtë në kuptimin estetiko-filozofik të fjalës, ndërsa të shkruash për gruan, aq më shumë në kontekstin e një shoqërie maskiliste si jona, është, jo thjesht, një kontribut krijues, por po aq edhe një obligim jetik, civil, përballë sfidës së madhe të integritetit sa brenda vetvetes, sa në Evropën e Re. Nuk është hera e parë që në krijimtarinë e Fadil Krajës gruaja, kjo kurorë e qenieve njerëzore, e gjen veten më shumë se sa tek asnjë shkrimtar tjetër i letërsisë mbarëshqiptare. Këtë prioritet, si qasje e pangjashme në letrat tona mund ta lexojmë, krejt lehtë, në të gjitha gjinitë letrare, të ushtruara prej tij, filluar me dramaturgjinë, ndryshe në mbi 50 drama, komedi dhe pjesë teatrale për fëmijë, sikurse në vëllimet poetike apo prozën e tij, tregimin dhe romanin.

Mjafton të “stacionohemi”, sado kallimthi, në “Fisheku në pajë”, “Gjaku i Arbërit”, “Çështja e Blertës” e te tjera, sikurse në “Kandidatja e fundit”, “Fajin e kishte Besa” apo tek “Balada e Nënës” e te tjera. për të lexuar në kodin e tij krijues, fatin e gruas, fatin e kësaj krijese, si vetë fati i shoqërisë shqiptare në rrugëtimin e saj sa të dhimbshëm, sa dinjitoz...

Ajo që bie në sy në këtë qasje artistike të Krajës, “Amazonat e Shkodrës”, është ndjeshmëria maksimale duke ofruar tek lexuesi sodisfaksonin që të jep emocionin estetik, kënaqësia artistike dhe mesazhi universal: Sa më larg konsideratës, apo hapave dinjitozë të gruas, aq më larg realizimit dinjitoz të vetvetes sonë si komb. Dhe veçanësisht e Fadil Krajës është guximi, brenda vetvetes, për ta parë drejt në sy dhe po aq për të besuar, pafundësisht, në vitalitetin dhe energjitë maksimale të gruas si njëra nga forcat kryesore të progresit shoqëror. “Unë jam gjysma e burrit tim, por edhe burri është gjysma ime ... Jemi një trup me dy krahë dhe përpqemi të fluturojmë drejt së mirës, drejt dritës ... shprehet Belma, njëra nga “heroinat” e Krajës.

Pikërisht kjo është epiqendra e përjetimit artistik në librin e tij, esse, të kohëve të fundit, “Amazonat e Shkodrës”. Epiqendrën e këtij vitaliteti, sikur madhështinë befasuese prej Feniks i lexon tek Shkodra grua, që thirret me emrin “Rozafë”, ndryshe bija e një legjende që në rrugëtimin e saj arrin të lartësohet madhërisht, në sytë e botës maskiliste të kohës, përmes një mbretëreshe, po ashtu legjendë, si Teuta ilire, qëdo të trondite me autoritetin e saj, sa ushtarak, sa moral, krenarinë e një perandorie si ajo e Romës, deri tek bijat e saja më të vona, si: Nora, Tringa, Hajria Hanëmi, Roza Shoshi etj. Sikur, në ditët tona, me gra, si: Zyliha Miloti, Tinka Kurti, Drane Xhaj, Violeta Sekuj, e te tjera deri tek më të rejtat si: Belma Çela, Ketil Bazhdari, Majlinda Jubani, Pranvera Meshnuni ... A nuk kam të drejtë, si autor i këtij refleksioni, të solidarizohem me idenë e autorit, se është diskriminues termi “burneshë” si pohim bishtnues, në kurriz të emrit grua si inferior ndaj emrit burrë, kur kujtojmë se Push-

kini, diell i poezisë ruse, afro dy shekuj më parë, anatemonte si diskriminues termin “nuse” për gruan e sapomartuar? Njëherish ..., kur kujton sukseset e jashtëzakonshme, gjatë një tranzicioni problematik, si yni, të 4 grave të fundit, në bizneset e tyre, tejet të vlerësuara brenda dhe jashtë vendit, a nuk i ngjajnë këto gra shkodrane, amazona, siç thekson z. Kraja, edhe Rozafës, edhe Norës, edhe Tringës, edhe Shejnazes edhe Marijes ..., edhe pse vepra e tyre nuk shoqërohet me britma, krisma, tym, baroti apo derdhje gjaku?!? ...”Pionieret, - na tërheq vëmendjen autori-, nuk kërkojnë të jenë njësha, zogj të truar që të përjetësohen në këngë. Ato nuk luftojnë, në asnjë kohë, për lavdi, por është lavdia që u shkon pas atyre. Ja, pra, pse pionieret janë amazona, disi ndryshe nga ato të antikitetit grek, sepse duan që të gjitha gratë të mos kenë nevojë të presin njërin gjë për të vlarë apo shmangur burrat e tyre në udhën e tyre të jetës, siç bënin amazonat greke, por të bëhen krah i burrit duke e ndihmuar dhe bërë, njëlloj si ai, punën e tij. Madje, po qe nevoja, apo e solli rasti, të zëvendësojnë burrat, të bëhen gjysma tjetër e tyre me emrin “grua”.

Dhe, padyshim, në këtë kontekst dhe shumë më gjërë, ka të drejtë “Mjeshtri i Madh”z. Kraja, kur rebelohet ndaj indiferencës bashkëkohore, sa individuale, sa kolektive apo institucionale, ndaj vlerave tona të afirmuara në mjedisin ku jetojmë dhe punojmë, si një shurdhëri mesquine, cmirëzezë, injoruese dhe kompromentuese e ecurisë sonë, civile, në postmodernitet.

Përballë këtij realiteti sa mjeran, sa provincial, njëri nga bijtë më të denjë të Shkodrës, Fadil Kraja, me dinjitetin civil prej krijuesi, intelektual dhe vizionari ngren si sfidë apelin e nderimit për së gjalli, në atyre që i dhurojnë vlera dinjitoze Shkodrës dhe kombit të tyre, si motivim në funksion të emancipimit të jetës sonë.

Ky vizion i Krajës, si një risi në këndvështrimin estetiko-filozofik, ndaj gruas në veçanti, në epokën e individimit ku historinë e bëjnë, jo heronjtë, por individët e lirë, duke lënë pas nderimin vetëm si rekuem, pas vdekjes, vjen si denoncim, në veçanti, i maskilizmit shqiptar, sa si krenari e kapërcyer në një shoqëri demokratike, sa si hipokrizi civile në emër të antinjeriut.

Dhe, nëse Kraja shtron me dhimbje faktin që asnjë gjurmë e Teutës, si emërtim bashkëkohor, nuk gjendet në asnjë cep të Shkodrës, ku ajo mbretëroi me aq madhësi duke sfiduar disa herë perandorinë romake, të gjithë ata që e duan vërtet Shkodrën kanë të drejtë të pyesin: Si mundet që asnjë shenjë nderimi për së gjalli nuk lexon në mjedisin shkodran me emra personalitetesh si “Mjeshtri i Madh” Fadil Kraja, po aq edhe ‘Krenaria e Shkodrës’, apo akademike i shquar, Prof.dr.Ahmet Osja”Mjeshtri i Madh”, anëtar nderi i 4 akademive, në Kosovë, Shqipëri, SHBA dhe Itali, apo aktorësh dhe këngëtarësh, si: Bik Ndoja, Besnik Çinari, Zef Deda, Bujar Qamili e të tjerë, e të tjerë?!

Kësaj radhe Fadil Kraja vjen para lexuesit të vet krejt ndryshe, jo thjesht me vizionin

tejet largpamës dhe të guximshëm si sfidë ndaj maskilizmit, sundues në shoqërinë tonë, nëse nuk sillemi si hipokrit me vetveten, por edhe me komunikimin përmes një gjinie letrare, si eseja, gjuha e së ardhmes,...

Madje, edhe pse në aspektin tipologjik kemi të bëjmë me rastin e një eseje joformale, ndryshe “esesë personale”, eseje krijuese, që disa e vlerësojnë edhe si një lloj kritike impresionuese, ku autori mbështetet në përvojën e tij personale, duke e trajtuar gruan, fatin e saj, në një këndvështrim estetiko-filozofik, origjinal, “Mjeshtri i Madh”Fadil Kraja, dëshmon po aq që, si krijues, nuk ka rënie, përsëritje apo ripërtypje, siç do të thoshte Kamy. Përkundrazi, duke vënë në plan të parë dashurinë për jetën si dashuri dhe respekt total ndaj gruas, ai konfirmon estetikisht, siç jam shprehur në librin tim “Kriza si de-hja nga entuziazmi modern” atë që pohojnë, sot, psikoseksologët:

“Të vetmit që e ndjejnë dhe e shijojnë dashurinë e vertetë janë vetëm 1 % e njerëzve dhe këta janë shkrimtarët, artistët, piktorët, muzikantët, poetët, estetët, këngëtarët dhe valltarët, sepse këta kanë ndjeshmërinë dhe sensitivitetin të ndiejnë përtej trupit”. Ndryshe këta janë dashnorët e jetës. Kraja i jep të drejtë Migjenit, poetit tonë të përmasave evropiane, që gruan e vlerësonte seksi i bukur, sikur Shkodrën “Dashnorja e Shekujve”, sepse vetë Fadil Kraja është një i tillë, dashnor i Shkodrës së vet...

Pa këtë Dashuri për Shkodrën, për bijat e saj, amazonat shkodrane të ditëve tona, promotore të së ardhmes sonë progresiste, si: Belma, Ketil, Majlinda dhe Pranvera e të tjerë nuk mund të jemi optimistë fatlum të Shkodrës të së Nesërmeres, sepse janë pikërisht këto bija të ndritura, të shquara në profesionet apo sipërmarrjet e tyre të lira, po ashtu si qytetare dhe familjare të denja që frymëzojnë dhe shtojnë përditë trasenë e kësaj Shkodre, me shembullin e shkëlqyer të sakrificës, të përkushtimit, si sfidë ndaj vetvetes, dhe paragjytimeve të lloj-llojit për të begatuar ditën tonë, kohën tonë..

Jo rastësisht, kur Shkodrës, dashnores së shekujve, po i vinin shqelmat, apo po i kthenin shpinën, jo pak nga bijtë apo bijat e saj, në kontekstin e një krize totale ku mbizotëronte kaosi dhe anarshia e pashoqe, amazonat e saj, si: Belma Çela, Ketil Bazhdari, Majlinda Jubani dhe Pranvera Meshnuni me bashkëshortët e tyre, guximtarët e sfidave me një risk të jashtëzakonshëm, si: Agroni, Paridi, Edmondi dhe Astriti, të cilët do t’i përvisheshin ndryshimit të madh, si ndryshim sa të vetvetes, sa të Shkodrës së tyre duke ndërmarrë sipërmarrje, jo të lehta, po aq si shembull i shkëlqyer për të rritur dhe edukuar fëmijët e tyre, djem dhe vajza, shembull sjellje në familje, në shkollë, në mjedisin publik. E, nëse sot Shkodra ka një “Grand Hotel Evropa”, si referencë dhe vlerë evropiane e shtuar në Shkodrën tonë, investim i çiftit guximtar, Blema dhe Agron Çela, siç ka edhe një ndërmarrje emërmadhe si Fasoneria,

ku janë të punësuar mbi 800 gra dhe vajza shkodrane, investim kurajoz i çiftit Ketil dhe Parid Bazhdarit, ka po ashtu edhe një biznes maskash, “Made in Albania Majlinda dhe Edmondi”, që ka përfaqësuar tregun global, Shkodra sot ka edhe një “Bixhisten” të ri, aty ku dikur ishte Pazarit i madh, që arriti të lulëzojë për disa shekuj, si identitet i saj, me 3 500 dyqane dhe një port të rëndësishëm, bri lumit Buna, nga ku tregtarët arrinin të kapnin dete dhe oqeanë, ndryshe si dëshmi dinjitoze e rilindjes si zogu Feniks, nga hiri i tij, investim dinjitoz i Pranvera dhe Astrit Meshnunit. Natyrisht këto arritje nuk qenë aspak të lehta.

E thotë shumë bukur Majlinda: “Maskat që prodhuam ne, filluan t’ua heqin maskat njerëzve.... Madje dy luftëtarët guximtarë, dy mosketierët Astriti dhe Pranvera dëshronin të çonin përtej, akoma më larg e më lart anijen e mendimeve të tyre të bukura e aq të mira për Shkodrën, por, fatkeqësisht, kapiteni i ri, vizionar dhe guximtar, që e desh aq shumë Shkodrën, vdiq tragjikisht dhe në mënyrë krejt të pamerituar ... Nuk mund të mos vihet në dukje se krahas përpjekjes për të rritur kapitalet e tyre si biznesmenë progresistë të 4 çiftet po aq punuan parreshtur edhe për kualifikimin e tyre profesional, brenda dhe jashtë vendit, sikurse vazhdojnë të shquhen për” frymën e tyre vjeneze” si mecenatë shembullorë në mbështetje të vlerave kulturore, sportive, shkencore e te tjere të Shkodraloces së tyre. Shembulli i amazonave shkodrane, njëra prej të cilave kandidon për Kryeqytetaren e parë të Shkodrës, më 21 qershor 2015, kam bindjen se do të meritojë edhe vullnetin e qytetarëve shkodranë duke e shpallur si shkodrania e parë kryebashkiake e Metropolit të Veriut. Njëherish, si intelektual pjesë aktive e jetës publike të këtij metropoli, kam bindjen që tek Ketil Bazhdari shumë më tepër se politikanen, thjesht përfaqësuese e një forca politike, qytetaria shkodrane, do të gjejnë Ketin, dashnoren e qytetarisë dhe të ndryshimit progresist të Shkodraloces, sepse znj. Bazhdari, me shembullin e saj të përkushtimit dhe të sakrificës, ka treguar prej vitesh vetveten si njëra nga qytetaret e denja, promotore e emancipimit shumëplanësh të Dashnores së Shekujve.

Përmes librit të tij eseistik, “Amazonat e Shkodrës”, me një seriozitet sa profesional, sa qytetar “Krenaria e Shkodrës” po aq “Mjeshtri i Madh”Fadil Kraja, si reaksion personal të kësaj eseje, na përcjell mesazhin kuptimplotë: “Nëse mediokrit, cmirëzinjtë, njerëzit e vegjël, thashethemexhinjtë” ata që nuk i arrijnë dot” duan vdekjen e të ndriturve, të asëve të çdo profesioni, apo sipërmarrje të lirë, ne kemi për detyrë që këta të fundit, ku gjejnë vetveten edhe amazonat tona, si promotore të të ardhmes progresiste të qytetit apo të kombit tonë, t’i glorifikojmë, ndryshe t’i lartësojmë duke hijeshuar denjësisht mjedisin tonë publik, apo institucional, me emrat e tyre, nën moton e shëndetshme të thënies së urtë popullore: “Ki inatin, por jepi hakun”.

Kadri Ujkaj, kritik letrar

NIK ÇARKU PRITET SI SIMBOL I KËNGËS SHQIPTARE NË MALSINË E MADHE

PËR PAK FUSHË E DISA MALE, NUK PO I THONË MALSI E MADHE, POR E MADHE ASHT BUJARIA, KU E MUER EMNIN MALSI

Malet e kësaj krahine mes alpeh zënë rrënjë buzë liqenit të Shkodrës dhe përfundojnë në Malësinë e Gjakovës, “me kryet deri në qiell” dhe majat e tyre të mbuluara me borë. Shpesh është thënë se ata kanë qenë frymëzim që malësorët të vinin në kokë qeleshet e bardha.

Rapsodët, poetët, studiuesit e përdorin shpesh këtë paralelizëm, siç përdorin edhe krahasimin midis maleve dhe malësorëve viganë, apo midis çikave dhe çetinave të rritura në shkëmb. Është kjoografi, ky reliev madhështor që ka frymëzuar rapsodët e lashtë për t’i kënduar bëmave dhe trimërive të Mujit e Halilit, të përjetësuar në eposin e lashtë shqiptar përmes një vegje të stërllashtë muzikore, lahutës.

Mijëra vjet, qindra luftëra, dhjetra pushtues janë përpjekur të hyjnë në qafat, luginat, pyjet, lumenjtë e përrënjtë e këtyre malave, por ata kanë qëndruar, ashtu siç thotë një këngë e vjetër: “Malet s’i luan era”.

I radhatur në këtë gjerdan të artë të vlerave kulturore është edhe këngëtari i njohur i Dukagjinit, miku i Malësisë së Madhe, i suksesshmi Nik Çarku, përfaqësuesi i këngës rapsodike, por edhe përçuesi i palodhur i kulturës tradicionale malësore në aktivitetet lokale e kombëtare, i cili njihet edhe si këngëtar popullor.

Ai ka fituar një popullaritet të gjërë, i cili shquhet për individualitetin artistik, që e bën të dallueshëm prej të tjerëve.

Të flasësh për karrierën e Nik Çarkut ka vetëm fillim, nuk ka fund, pasi karrira është aq e gjatë saqë nuk i shkon për shtat fjala fund.

Fama dhe vlerat e këtij këngëtar, mori trajtën e një bilbili, që me zërin e tij të bukur nuk njeh kufinj, sepse kënga e Nik Çarkut ka vite që është e pranishme në të gjitha trevat shqiptare.

Për vlera dhe kontribut të madh në ruajtjen dhe transmetimin për brezat e ardhshëm, pasurisë së madhe artistike dhe shpirtërore të Trevës së Malësisë së Madhe, si dhe për ta përjetësuar madhësinë e rapsodit legjendar Sali Mani, Nik Çarku me një tekst nga Kadri Fikaj i ka kënduar këngën “Sali Manin t’gjall’ e kena”.

Në repertorin e këngëve të kënduara nga Nik Çarku, ndër këngët më të njohura janë: “Ndhimo zot të bajmë konak” me tekst të Gjok Becit, muzikë të Mark Gjokës, “Atje mbretër janë te tanë”, me tekst të Sali Manit dhe muzikë të Nik Çarkut, si dhe shumë këngë të tjera epike dhe lirike pa lënë pas edhe këngët e dashurisë siç është kënga “Luj Lirie, luj” me tekst dhe muzikë nga Nik Çarku, realizuar në Amerikë, e cila për shumë vite me radhë u bë hit, si dhe shumë këngë të tjera që pasojnë njëra-tjetrën.

Këshilli i Komunës Gruemirë, Malsi e

Madhe me kryetar Z.Lirim Nehanaj dhe Presidenti i Shoqatës Atdhetare “Malsia e Madhe” Z. Ilmi Bajram Kurti, si dhe Kryetari i Komunës Rrethina e Shkodrës Z. Luan Harusha, në Art Center, në ambientet e TV “Blue Sky”, e nderuan z. Nik Çarku me titullin “Qytetar Nderi”, ku mori pjesë edhe znj. Ketil Bashdari, kandidate për kryetare bashkie në Shkodër.

Përmes emocioneve në mes të pranishmëve në fjalën e tij z.Nik Çarku, pasi foli për jetën e tij artistike, bëri një pasqyrim plot vërtetësi të kontributit të artistëve malësorë në kulturën shqiptare, duke sjellë para auditorit emra të mëdhenj e të paharrueshëm si Sali Mani, rapsodi i papërsëritshëm, Lukë Kaçaj, basisti me famë botërore, Angjelin Përlocaj e shumë e shumë të tjerë për të cilët është e nevojshme që një ditë të flitet më gjërë.

Ky vlersim i dedikohet të gjithë mal-

tij do të jetë edhe një album me këngë të reja, secila më e bukur se tjetra.

Gjithashtu ai falenderoj znj. Ketil Bashdari, e cila gjatë kësaj fushate të madhe gjeti momentin që ta respektojë.

Kënaqsi dhe sadijsfaksion ishte edhe për mua që po shkruaj këtë artikull, sepse të kesh mik Nik Çarkun është një pasuri e çmuar e shpirtit, pasi ai është një malësor zemërbardhë me shpirt floriri, misionar i kulturës dhe traditës shqiptare dhe jo vetëm kaq, por rastësisht u ndodha mes malsorëve të nderuar dhe mikpritës që pas një interviste që këngëtari Nik Çarku dha në televizionin e Koplikut, ku i ftuar në studio ishte edhe Presidenti i Shoqatës Atdhetare “Malsia e madhe” Z. Ilmi Bajram Kurti, shumë bashkmoshatar të tij, por dhe malësorë të nderuar, kishin ardhur për tu takuar dhe përshendetur me këngëtarin Nik Çarku, të cilit ata i sh-

tjera ai realizoi edhe dy videoklipe shumë të bukura në TV “Blue Sky” si dhe një këngë titulluar “Njiqind vjet Malsia priti” me tekst të Ilmi Kurtit, e cila u realizua nga stafi i TV “Kopliku” me mjeshttrin e talentuar Artur Hoxhaj.

Po ku je lahutë moj zanë
Bashkë me Fishten k’ndove kangë
Për Malsinë, Malsinë e Madhe
Që n’kohë t’moçme pat shumë halle
Dhe pushtuesit shkojnë e vijnë
Por se tremben kurr Malsinë
Gjaku ujë kurr nuk tu ba
Nipi t’parve u paska ngja
Ilmi Kurti n’at bregore
Ngritë iu ka një përmendore
Njiqind vjet boll ka pritë
Me ju qitë gjakun në dritë
K’tyre trimave në k’to male
Që janë nderi Malsisë Madhe

Në rrjedhën e krijimtarisë së ti të re ai realizoi edhe një këngë tjetër titulluar “Bir i denj i Dukagjinit” me tekst nga autori i këtij shkrimi, me muzikë të Nik Çarkut, orkestruar nga Behar Neli, për të cilën bëri edhe një videoklip brilant, për të nderuar personazhin më të spikatur publik të qytetit të Shkodrës, për kontributin e tij në vite në fusha të ndryshme sociale, kulturore dhe artistike të jetës, i cili me mençurinë dhe mjeshturinë e veprave të tij ka bërë një emër si simbol bamirësie, shkodrani i suksesshëm me banim në Amerikë z.Ndue Ftoni, i cili është një ndër biznesmenët më të fuqishëm në Detroit dhe Michigan, por mbi të gjitha me një stacion televiziv shqiptar, ku promovohen vlerat e kombit tonë, duke u bërë kështu një ambasador i vërtetë.

Mund ta quajmë atë mecenat, sepse i ndihmon të gjithë artistët në SHBA. Mund ta quajmë atë një njeri që ndihmon Shkodrën, sepse vjet organizoi për të paren herë dhe do ta bëjë të përvitshme “Nata Shkodrane”, me humor dhe muzikë nga Shkodra. Sivjet dhe për çdo vit ai do ta bëjë në muajin maj dhe do ta quaj përsëri “Nata Shkodrane” dhe pjesmarrja siç ishte vjet prej 1000 vetë, do të jetë përsëri edhe në vitet e ardhshme.

Në të vërtetë puna e Nik Çarkut si këngëtar i shquar shumë planesh ka shkëlqyer për afro 20 vjet nëpër festa e dasma në kurbet në Amerikën e largët, por motivi, krenaria dhe frymëzimi i Nikës ka qenë Atdheu e Kombi dhe me të drejtë ka ligjeruar fuqishëm në një nga këngët e tij “Atje mbretër janë te tanë”! E them me bindje se Nika ka kontribuar për Kombin tonë e në veçanti për Trevat veriore të Atdheut, duke treguar fuqishëm mirënjohje e respekt për këngën dhe artin.

Ramazan Çeka



sorëve që na kanë mbështetur moralisht drejt suksesit. Një përshendetje vëlazërore kam edhe për ata instrumentistë që kanë kontribuar ndër vite për Malsinë e Madhe, por që sot për arsye të ndryshme ndodhen larg vendlindjes. Një dedikim të veçantë kam edhe për ata artistë që sot fatkeqësisht nuk jetojnë më, por që do të mbeten përjetësisht në memorien tonë dhe të brezave që do të vijnë për artin e bukur që ato na trashëguan.

“Gjithmonë do të jem pranë jush me zemër e mendje dhe me këngën time, do të nxjerr në dritë figurat e shquara të Malsisë së Madhe, Dukagjinit, Rrethinave dhe qytetit të Shkodrës me një histori të lashtë dhe legjendare, për të cilat kurr nuk do të kursehem”.

Këngëtari i shquar, shumë planesh, Nik Çarku fjalën e tij e mbylli duke premtuar se do të vazhdojë të përkushtohet gjithnjë edhe më shumë për vlerat që Malsia e Madhe, si dhe në projektet e




truan edhe një drekë në lokalin “Sharani” ku herë pas here njerzit vinin duke vërshuar njëri pas tjetrit.

Pritja që iu bë Nikës ishte disi e veçantë, pasi nga dashuria e madhe për tu takuar dhe biseduar me te, u krijuan edhe momente shumë interesante. Jemi mësuar që për artistët të flasim me superlativa, por krejt ndryshe ndodhi në këtë takim. Aty nuk pati superlativa, por mall, ndjenja atdhedashurie vllazrore, vlersime me fjalë zemre e shpirti, saqë në një moment Nika u përlot kur nga një malësor i nderuar, nip i këngëtarit të paharruar Sali Mani, dëgjoj të thirrej “Axxhë”. Të gjithë të pranishmit aty u emocionuan nga ky takim aq miqësor dhe i shumëpritur.

Këngëtari Nik Çarku gjithmonë ka kënduar për burrat e dheut, për Dëshmorët e për Kombin dhe për këtë malësorët krenohen që e kanë birin e tyre, shok e mik.

Këtë herë krahas shumë këngëve të

Botime të reja *** Botime të reja *** Botime të reja *** Botime të reja



REDAKSIA

Kryeredaktor: Luigj Shyti

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Mundësoi
Botimin:

NDUE FTONI

